



PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 4 (katërt) të rregullt për vitin 2026,të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	26.03.2026
Ora:	12:00

Prezentë në takim:

Znj. Sanie Kuçi
Rexhepaj

Z. Flamur Bytyçi

Znj. Doruntina Zenelaj

Z. Urim Suka

Z. Astrit Salihu

Z. Nexhat Ramadani

Znj. Vlorë Kryeziu

Znj. Dafina Kolgeci

Z. Bexhet Kuçi

Znj. Albulena Kokollari

Z. Edon Sadikaj

Z. Aziz Bytyçi

Znj. Mimoza Bajraktari

Z. Enver Shabani

Znj. Besa Kuçi

Z. Syl Zenelaj

Z. Ilir Voci

Z. Dardan Berisha

Z. Labinot Halitjaha

Znj. Merita Basha

Z. Demokrat Vataj

Znj. Antigona Zyba

Z. Liridon Fandaj

Z. Qëndrim Elshani

Znj. Laureta Tafaj

Znj. Jehona Rrafshi

Lumi

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj. Habibe Bytyqi

Z. Xheladin Sadikaj

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

REND DITE

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Sqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Suharekës;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale „Eko Theranda“;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;**
5. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;**
7. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të komunës për ndarjen e mjeteve financiare;**
8. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;**
9. **Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - kemi edhe një pikë shtesë e cila pikë ka të bëjë me shfuqizimin e vendimit Nr-016-9877.

Kryesuesi jep sqarime sa i përket këtij projekt-vendime dhe kërkon që të futet në rend dite.

Urim Suka - kërkoj që me mirëkuptimin e të gjithëve që përveq pikës që ju sapo apostrofuat,të kemi edhe një pikë shtesë të re të propozuar nga ana jonë.Këto ditë ne si LDK jemi niftuar që në një nga zyret e dektorive të komunës është hequr fotografia e ish Kryetarit Ukë Bytyçi.Kjo sjellje për neve është e papranueshme,e dënueshme dhe kërkon diskutim për me ditë se çka ka ndodh.Kërkesa jonë është aq më e fuqishme kur dihet që ekziston një vendim i Kuvendit të komunës që e rrgullon këtë çështje se ku duhet me qenë fotografia e ish Kryetarit Ukë Bytyçi.Ajo që na shqetëson edhe më shumë është fakti që Kryetari i Komunës ka qenë i njoftuar për këtë akt dhe deri në këto momente nuk e ka marrë asnjë veprim.Ne besojmë fuqishëm që përtej vendimit,vendosja e fotografisë së ish Kryetarit Ukë Bytyqi nëpër drejtori ashtu siç është e rregulluar në vendim do ti bënte nder edhe secilës drejtori dhe secilit institucion.Andaj kërkoj mirëkuptimin e secilit që ta fusim pikë të rendit të ditës që ta diskutojmë këtë çështje dhe të marrim informatat e nevojshme.

Liridon Fandaj - sa i përket projekt-vendimit për shfuqizim që ka ardhë,asamblenë e kaluar kam kërkuar që ai projekt-vendim të korigjohet dhe të caktohet vlere financiare ashtu siq ka kërkuar Ministria.Ju ose jeni kundër atij biznesi ose kundër interesit publik.Për deri sa komisioni ka vendos me dhënë me atë përqindje,të paktën një projekt ideor dhe financiar e ka pas ai edhe atë 21% me kthy në vlere financiare,dhe sot mos m'u vonu as investitori.Unë propozoj që ju me angazhu një kompani ligjore dhe këto vendime mos t'na kthehen prap për gabimet e kuvendit komunal.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e parë shtesë për rend dite.

15 për, 8 apstenime, Miratohet pika shtesë

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e dytë shtesë për diskutim në rend dite nga grupi i LDK-së.

13 për,11 kundër,1 apstenim

Urim Suka - me mirëkuptimin tuaj kërkoj që pika shtesë që kërkoja të jetë pikë e parë në rend dite.

Kryesuesi - është fut si pikë shtesë dhe shkojnë me rend pikat.Vetëm pika pyetje dhe përgjigje mbetet e fundit.E hedh në votim rendin e ditës me pikat shtesë.

17 për,8 apstenime,Miratohet rendi i ditës me pikat shtesë

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kalura;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

23 vota për,Miratohet pika 1

Pika 2. Sqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Suharekës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe ia kalon fjalën zyrtarit ligjor pasi ka qenë punues i kësaj rregullore.

Avni Bytyqi - me kërkesën e Ekoregjionit, njesisë në Suharekë, Kryetari i komunës ka inicuar procedurën e hartimit të projekt-rregullores për menaxhimin e mbeturinave si dhe për caktimin apo propozimin e tarifës për mbeturina në territorin e komunës tone dhe nga ai moment Kryetari ka themeluar grupin punues prej 5 anëtarëve dhe njeri prej tyre kam qenë edhe unë ku e ka kryesuar grupin punues dhe e kemi hartuar këtë projekt rregullore. Projekt-rregullorja ka tri ligje bazike e cila i ka si baza ligjore për të dhënë kompetencë dhe mandat kuvendëve të komunave që të miratojnë një rregullore të tillë me qëllim që t'ju krijohen kushte më të mira kompanive apo ndërmarrjeve që menaxhojnë në çështjen e mbeturinave. Është ligji për qeverisje lokale si ligji bazik të neni 17 Kompetencat vetanake të komunës, të cilat i jep mandat dhe kompetencë komunës që të merret me trajtimin dhe menaxhimin e mbeturinave. Po ashtu është ligji për financat e pushtetit lokal që i jep kompetencë dhe mandate komunave që të caktojnë të hyra vetanake apo tarifa për shërbime që ofrohen, si dhe ligji bazik, ligji për mbeturinat i cili e obligon komunën që të hartojë rregulloren për çështjen e përcaktimit të menaxhimit të mbeturinave, të përcaktojë kushtet dhe kriteret se si të menaxhohen mbeturinat në territorin e komunës së Suharekës si dhe të përcakton orarin, kushtet dhe po ashtu i jep mandate të përcakton tarifën për të cilën ofrohet shërbimi nga komuna apo nga kompania për të cilën e ka kontraktuar komuna. Kjo rregullore ka për qëllim që të rregullojë çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe mbeturinave nga aktivitetet tjera të natyrës së ngjajshme me ato të amvisërisë, lartësinë e tarifës së taksës për menaxhimin e mbeturinave nga amvisëritë. Mbeturinat komerciale, mbeturinat institucionale me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm për administrim financiar, ruajtjes së natyrës, ambientit jetësor dhe interesit të përgjithshëm për të gjithë qytetarët e komunës tone të cilët jetojnë dhe veprojnë në komunën tonë. Po ashtu në këtë rregullore kemi parapa që ti prejashtojmë edhe mbeturinat të cilat nuk janë të lejuara që të trajtohen nga komuna. Janë të parapara përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës përball gjeneruesve të mbeturinave dhe atyre që i grumbullojnë mbeturinat, sistemi i menaxhimit të mbeturinave, kategorizimi i mbeturinave, regjistri i të dhënave të cilën e ka obligim edhe komuna dhe kompania e cila merret me menaxhimin e mbeturinave, përcaktimi i tarifës dhe grumbullimi i të hyrave nga caktimi i tarifës për mbeturina dhe po ashtu janë parapa edhe veprimet e ndaluara që janë të sanksionuara edhe me ligjin për mbeturina dhe me udhëzimet administrative që derivojnë nga ligji për mbeturinat. Në fund janë dispozitat ndëshkuese, mbikqyrja e kësaj rregullore dhe po ashtu hyrja në fuqi se kur kjo rregullore fillon të aplikohet në komunën tonë.

Albulena Kokollari - Menaxhimi i mbeturinave është një nga shtyllat kryesore të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Si ekologe, e konsideroj këtë fushë jo vetëm si obligim institucional, por si mision. Një sistem i mirëfilltë i menaxhimit të mbeturinave nënkupton reduktimin në burim, riciklimin, ripërdorimin dhe trajtimin e duhur të mbetjeve – duke minimizuar ndikimin negativ në tokë, ujë dhe ajër. Kur nuk menaxhohen siç duhet, mbeturinat shndërrohen në burim ndotjeje që prek drejtpërdrejt shëndetin e qytetarëve, cilësinë e ujrave, degradimin e tokës dhe biodiversitetin. Prandaj, kjo rregullore nuk është vetëm një dokument formal – është një instrument që vendos standarde, përgjegjësi dhe mekanizma konkretë për mbrojtjen e mjedisit në komunën tonë. Në thelb, ky dokument nuk rregullon vetëm mënyrën si i menaxhojmë mbeturinat, por përcakton mënyrën si e mbrojmë shëndetin tonë, mjedisin dhe të ardhmen e qytetit tonë. Duke u ndërlidhur me këtë temë, dua të theksoj edhe përvojën time gjatë kohës kur kam shërbyer si drejtoreshë e inspektionit. Në atë periudhë, bashkë me inspektorët e mjedisit kemi bërë një punë të madhe në mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Me këtë rast, dua të falënderoj të gjithë inspektorët për profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre. Po ashtu, shfrytëzoj rastin të falënderoj kompaninë “Ekoregjioni” për bashkëpunimin korrekt që kemi pasur gjatë kësaj kohe. Së bashku kemi arritur të identifikojmë dhe eliminojmë shumë pika problematike, si dhe të shtojmë numrin e kontejnerëve aty ku ka qenë e nevojshme. Në këtë drejtim, nuk mund të mos i përmendim dhe falënderojmë të gjithë punëtorët e kompanive të pastrimit, të cilët çdo ditë, shpesh në kushte jo të lehta, kujdesen për pastërtinë e qytetit tonë. Është obligim i yni që këta punëtorë të kenë kushte më të mira pune dhe paga më dinjitoze. Një element kyç në këtë proces është ndërgjegjësimi qytetar. Ky ndërgjegjësim duhet të fillojë që nga bankat shkollore. Shkollat dhe mësimdhënësit kanë një rol të pazëvendësueshëm në edukimin e brezave

të rinj për mbrojtjen e mjedisit. Përmes edukimit mjedisor, ne nuk formojmë vetëm nxënës më të informuar por edhe qytetar të përgjegjshëm. Përvoja jonë si të rinj të Suharekës e dëshmon këtë - përmes aksioneve vullnetare kemi pastruar hapësira publike, kemi vendosur elemente vetëdijesuese si drunj me mbishkrime sensibilizuese, kemi krijuar zgjidhje praktike si shporta për mbeturinat e cigareve, kemi organizuar punëtori dhe aktivitete të shumta ndërgjegjësuese, si dhe kemi marrë pjesë aktive në shënimin e Ditës së Tokës. Këto aktivitete tregojnë se kur ndërgjegjësimi dhe angazhimi bashkohen, rezultatet janë konkrete dhe të dukshme. Komuna e Suharekës për disa vite radhazi ka përfituar projekte të rëndësishme në fushën e mjedisit si rezultat i performancës së mirë institucionale. Këto arritje janë dëshmi e një pune të mirëkoordinuar dhe profesionale, e cila reflekton edhe prioritetet dhe fokusin e vazhdueshëm të Kryetarit të Komunës për mbrojtjen e mjedisit. Projektet si: pastrimi i deponive ilegale, pastrimi i lumenjve, ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza dhe projekte të tjera janë kontribut i Kryetarit të Komunës, z. Bali Muharremaj, i cili i ka dhënë prioritet promovimit të mbrojtjes së mjedisit. Komuna e Suharekës është bërë shembull në organizimin e aktiviteteve si Dita e Tokës dhe në ngritjen e vetëdijes qytetare, gjë që është reflektuar edhe në vlerësimin e saj si një nga qytetet më të pastra në Republikën e Kosovës. Ky sukses tregon qartë se bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet institucioneve, shkollave, qytetarëve dhe kompanive të pastrimit, si dhe respekti për punën e tyre, sjell rezultate konkrete. Falë këtij bashkëpunimi, pas çdo feste, pas çdo dite tregu apo organizimi, hapësirat tona pastrohen menjëherë, duke mos lënë hapësirë për ankesa. Të nderuar kolegë, kjo rregullore është një hap i rëndësishëm drejt një sistemi modern dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave. Si ekologe dhe si përfaqësuese e qytetarëve, ju ftoj që ta mbështesim dhe ta miratojmë atë. Në fund, dua të theksoj edhe fushatën nga fondacioni Golden Eagle, e cila përmes iniciativës "Golden Eco" i kthen mbeturinat në mundësi dhe bën thirrje që përmes riciklimit të ndihmohen familjet në nevojë.

Qëndrim Elshani - nuk mund të kërkojmë prej qytetarëve tonë të paguajnë tarifa më të larta ndërkohë që ne si Asamble nuk u garantojmë atyre shërbim ma cilësor e aq ma pak kur nuk u garantojmë punëtorëve të terrenit që djersa e tyre duhet të vlerësohet. Qëndrimi ynë është parimor. Pra pa një klauzol të qartë ligjore brenda rregullores që specifikon se rritja e të hyrave do të alokohet drejtëpërdrejtë për rritjen e pagave dhe përmirësimin e kushteve të punëtorëve të mbeturinave grupi i LVV-së voton kundër.

Liridon Fandaj - ne jemi kundër kësaj rregullore. Kjo rregullore edhe herën e kaluar ka ardhë dhe tash me një komision tjetër por prap pa konsult me qytetarët. Debatet publike që i bëni për një rregullore do të duhej që edhe neve si Asamble t'na vje njoftimi. Në asnjërin fshat nuk ka pas njoftim për për këtë debat. Pa konsult të qytetarëve kjo rregullore nuk do të duhej të kalonte. E kam përcjell edhe asmblenë e Rahovecit dhe kjo rregullore nuk ka kalu dhe e vetmja arsye ka qenë që duhet m'u konsultu me qytetarë për me rrit. Nëse ne kemi m'u thirrë në atë që duhet m'u rrit rrogat e punëtorëve të Eko Rgjionit, ne jemi për por në rregullore nuk e keni fut në asnjërin nen që me të hyrat që do të mblidhen nga mbeturinat do të rriten pagat e punëtorëve. Kështu si e keni sjell këtë rregullore nuk duhet të kaloj.

Flamur Bytyçi - edhe në KPF e kemi kundërshtu këtë rregullore. Ka gabime në dokument, p.sh te neni 8 përsëritet dy here. Për veç gabimeve në këtë dokument për mua është e paqartë dhe e pa arsyetueshme çështja se si janë vendos çmimet. Si janë vendos 15 € për biznese, çka keni marrë shembull? U cek që kjo kërkesë ka ardhë si rezultat i Ekoregjionit por ne asnjëherë në seance dhe as mandatin e kaluar nuk kemi pas ndonjë pasqyrë të asaj ndërmarrje edhe pse jemi aksionar 13%. A është kalkulu këtu edhe paga minimale që ka m'u ndryshu në të ardhmen apo vetëm janë vendos çmimet krye në veti? Unë kërkoj të jepni një arsyetim se si janë vendos çmimet? Në bazë të amortizimit të automjeteve, ngritjes së çmimit të naftës, ku jeni bazu? Është thënë në KPF, nëse nuk gaboj që në të ardhmen mbeturinat do të menaxhohen nga Eko Theranda, si ka m'u rregullu kjo çështje? A keni zhvillu bisedime për këtë? Është cek në rregullore themelimi i sektorit për menaxhimin e mbeturinave, qysh ka me u bë ai sistem? A keni parapa kosto sa do të kushtoj sistemi për regjistrin e konsumatorëve? Gjithëashtu kam kërku në KPF edhe një raport financiar nga anëtari jonë i aksionarëve në Ekoregjion. Ndoshat duke u thirr që jeni në krizë, sa janë borgjet?

Avni Bytyqi - ne i kemi propozu tarifat dhe ju e keni obligim ta miratoni apo mos ta miratoni këtë çështje që ne si grup punues e kemi propozu. Për here të pare në komunën tone propozohet tarifa për ekonominë familjare me dy kategori. Kategoria e njesive familjare që ne kemi vlerësu dhe kemi mendu që do të jetë një tarifë prej 6 €, me një rritje simbolike dhe tarifat individuale ku jemi të vetëdijshëm që

ka shumë familje që jetojnë me një anëtar apo dy anëtar më së shumti. Kemi parapa edhe kategorinë konsumatorëve komercial apo industrial si dhe konsumatorët institucional. Kërkesa e kompanisë ka qenë që vlera e tarifës së paku të jetë 7 € dhe i njëjti propozim ka qenë edhe i Kryetarit të komunës që tarifa të bëhet 7€ për ekonomitë familjare por ne si grup punues kemi vlerësuar se tarifa prej 6 € për ekonomitë familjare është tarifë simbolike dhe besoj që së paku në aspektin financiar i plotëson kushtet për ndërmarrjen Ekoregjioni. Ka shumë faktor pse duhet të propozohet rritja për menaxhimin e mbeturinave. Faktor kryesor është gjendja financiare e vështirë e kompanisë. Faktori i dytë është rritja e tarifave nga niveli qëndror për deponimin e mbeturinave ku deponohen mbeturinat nga ndërmarrja publike të cilat i menaxhon mbeturinat e që është vetëm një në regjionin e Prizrenit e cila është në Landovicë dhe tarifata atje ka tri vite që janë rrit në krahasim me tarifata që ne i kemi aktualisht. Faktori tjetër është rritja e kostos financiare për shpenzimet e mirëmbajtjes së makinerisë së teknikës të ndërmarrjes Ekoregjioni (njësia në Suharekë) si dhe rritja e kostos financiare për paisjet tjera, duke përfshirë veshmbathjet, dorezat, lopatat, fshesa e të gjitha. Një prej faktorëve kyç është edhe rritja e derivative të naftës që e ka shty komunën që të iniciojë këtë procedure dhe ti propozojë kuvendit rritjen e tarifave. Faktor tjetër është rritja e tarifave të ujit. Kompania Ekoregjioni për çdo përfundim të orarit ka për obligim që ti pastron dhe ta mirëmban makinerinë. Faktor tjetër është edhe rritja sa do pak e pages së punëtorëve që ka reflektuar më herët e që nuk ka reflektuar rritja e tarifës në komunën tone dhe nëse kjo rregullore miratohet besoj që ka me ndiku edhe në rritjen e mirëqenies së punëtorëve.

Dafina Kolgeci - për shkak të natyrës së profesionit tim shqetësimi im është te pika për mbeturinat medicinale. Hartuesit e këtij programi mendoj që kanë gabu ose nuk janë mjaftueshëm të informuar në mënyrën se si funksionon asgjësimi i mbetjeve medicinale. Kjo punë është rregulluar me ligj përmes Ministrisë së Shëndetësisë dhe ka vite që çdo institucion shëndetësor, kryesisht privat është i obliguar që të ketë kontratë asgjësimi me spitalet rajonale. Në rastin konkret Suhareka e ka me spitalin e Prizrenit. Pse ekziston ky nen? Kërkesa ime është që të largohet kjo pike sepse bëhet konfuzion për institucionet publike shëndetësore kujt me iu drejtu për asgjësimin e mbetjeve medicinale. Mendoj që komuna nuk i ka paisjet, nuk e ka infrastrukturën, nuk i ka kuadrot njerëzore për asgjësimin e këtyre mbetjeve.

Liridon Fandaj - me shumë ato që i tha zyrtari ligjor pajtohem për shkak të shpenzimeve dhe gjendjes financiare të Ekoregjionit por ligji për prokurim publik nëse ne e miratojmë këtë rregullore, nuk e favorizon një kompani. Me këtë rregullore mund të konkuroj edhe një kompani tjetër për mbledhjen e mbeturinave dhe mos të thirremi në atë që kjo rregullore është bërë vetëm për Ekoregjionin. Nëse kjo rregullore është bërë për rritjen e pagave të punëtorëve, jemi pro. Por nëse kjo rregullore është bërë vetëm për tarifa dhe nesër një kompani tjetër mundet me konkuru dhe me marrë këtë, atëherë ne jemi kundër sepse nuk mund ta favorizojmë dikënd tjetër në dëm të qytetarëve.

Urim Suka - sa here që ne kemi diskutu për rregulloret kemi bërë përpjekje që rregulloret t'i shohim me syrin e mirë dhe me prova se çka mund të bëjmë që ato të miratohen me qëllim që komuna të rregullojë diçka në fushëveprimtarinë e vet. Kur jemi te rregullorja në fjalë komuna veq e ka një rregullore në fuqi të vitit 2020 dhe kjo ndoshta nuk e ka ndonjë emergjencë të madhe që ne ta bëjmë një rregullore të shpejtë edhe me gabime siq i cekën edhe parafolësit disa nga shqetësimet që u thane për këtë rregullore. Kjo rregullore në legjislaturën e kaluar është trajtuar tri herë dhe tri here nuk ka kaluar për shkak të vërejtjeve që janë dhënë atëherë. Ajo që më shqetëson edhe sot është që dallimi mes rregullores 2020 dhe rregullores që e kemi sjell, në përmbajtje është shumë i vogël te ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarët. Ndërsa në aspektin e tarifave gati ndryshimi është 100%. Në bazë të rregullores dhe gjendjes në teren ka disa mospërputhje. P.sh. te neni 4 ku flet për llojet e mbeturinave të cilat i trajton, ti menaxhoj në bazë të kësaj rregullore, aty përmenden shumë lloje të mbeturinave, si amvisëria, mbeturinat inerte, mbeturinat e vëllimshme, shtazore, mbeturinat nga demolimi e të tjera. Por ajo që funksionon në teren është që qytetarët përmes Ekoregjionit marrin vetëm mbeturinat e amvisërisë. Te neni 6 pika 6.5 thotë që komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat. Ky nen a nënkupton që ne kemi me hap një procedurë dhe kemi m'ë ja dhënë dikujt privat me i kry këto shërbime? Kjo do të kishte kuptim nëse Ekoregjioni nuk po mundet me i përballu të gjitha fshatrat dhe i nevojitet dhe një kompani tjetër që e kryen këtë shërbim, ndoshta do të kishte kuptim me ia dhënë dikujt privat. A ka nevojë me pas edhe një kompani private që e rregullon këtë çështje apo jo? Pastaj kjo kompani a e rrezikon Ekoregjionin në funksionimin e vet apo s'e rrezikon? Pika 6.17 obligon Drejtorinë e Shërbimeve Publike që të bëjë hartimin e një plani komunal për menaxhimin e mbeturinave. Edhe rregullorja paraprake e ka pas pikën e njëjtë. Dua të di a ka komuna një plan për

menaxhimin e mbeturinave dhe nëse ka një plan, pse nuk ka ndodh menaxhimi i mire i mbeturinave kur edhe plani ekziston? Nëse nuk ka, duhet të bëhet ky plan. Çështje tjetër që dua ta ngris është te familjet me rastet sociale. Unë nuk kam pa që kjo rregullore parasheh që familjet me raste sociale të lirohen nga pagesa. A duhet në këtë rregullore me parapa edhe një nen që i largon disa familje nga kjo pagesë apo nuk i largon nga kjo pagesë? Ajo që më çudit është edhe ndarja në zona te intersat e konsumatorëve komercial-industrial. Ndarja është në tri zona. Zona A, zona B dhe zona C.P.sh. një lokal afarist komercial në Reshtan ngarkohet me fatura të zones A, që nënkupton që çmimi është më i lartë, ky tjetri në Semetisht në zonën C. Si në Reshtan te shkolla dhe si në Semetisht mendoj që pak a shumë është e njejtë. Mendoj që në këtë rast ndarja e zonave nuk ka respektu kriteret. Fokusi i juaj për me shty këtë rregullore nuk ka qenë për me ofru shërbime ma të mira për qytetarët por ka qenë për me iu ngrit tarifat, që unë besoj që ka edhe arsye siq i përmendi edhe Avniu por fokusi duhet me qenë te ofrimi i shërbimeve më të mira. Duke i parë gjithë këto që unë i thashë, ne si grup i asambleistëve nuk e mbështesim këtë rregullore në këtë formë, përveç në rastet që zotimet që ne i dhamë ndoshta i fusni si pjesë e rregullores, atëherë gjatë diskutimeve mund të shohim.

Kryesuesi - Urim, shërbimet që i kryen Ekoregjioni a janë të mira apo nuk janë të mira?

Urim Suka - nuk po i analizojmë këtu vetëm shërbimet por komplet rregulloren. Ajo që ofron Ekoregjioni sot është e shkëlqyer. Ekoregjioni i merr vetëm mbeturinat e amvisërisë dhe unë për atë pjesë jam në rregull. Ajo që unë ngrita është për komplet rregulloren.

Avni Bytyqi - vet ti e potencove që jemi të kënaqur me shërbimet e Ekoregjionit. Ligji për mbeturina i vitit 2012 i cili është plotësu-ndryshu në vitin 2022, i jep kompetencë dhe mandate komunave nëse e ka të arsyeshme që një operator nuk mund ta mbulojë të gjithë territorin e komunës së vet, e jep mundësinë që të kontraktin edhe operatorë të tjerë me qëllim që të kryhen shërbime sa më të mira për qytetarët. E dyta ishte plani për menaxhimin e mbeturinave. Vet ti e ke miratu në vitin 2024 planin për menaxhimin e mbeturinave për periudhën afatmesme 2024-2027 dhe sa po zbatohet ajo është temë tjetër. Ishte edhe çështja e rasteve sociale. Ne kemi diskutu edhe me përfaqësuesin e Ekoregjionit dhe vërtetë e ka arsye që nuk duhet të parashihen në këtë rregullore rastet sociale që ti lirojë kompania por kjo çështje le të jetë në kompetencën dhe mandatin të komunës nëse e sheh të arsyeshme në bazë të kërkesave që i sjell kompania, vërtetë e bind komunën që janë raste që duhet të merret edhe komuna, kemi mendu dhe vlerësu që këto obligime duhet ti merr komuna dhe jo të dëmtohet kompania

Janë afër 500 familje në komunën tonë me raste sociale dhe nëse i lirojmë vërtetë kanë vështirësi financiare ti mbulojnë këto. Nëse e shihni të arsyeshme një propozim shtesë ne kemi me ardhë dhe rastet sociale le ti merr për obligim komuna.

Urim Suka - nëse e kuptova Avnia tha që rastet sociale le ti adreson kompania. Kompania i ka hallet e veta të funksionimit të vet dhe ne, ju që e keni propozu këtë duhet me u shqetësu për hallet e qytetarëve. Ne mund të themi që 6€ janë pak por për një familje që janë me social, janë shumë.

Avni Bytyqi - po e citoj një fjalim të përfaqësuesit e Ekoregjionit njesia në Suharekë. Vërtetë më ka thënë që ka raste sociale që kushtet ndoshta i ka edhe më të mira se disa të tjerë, ka vetura nëpër oborre dhe bën problem për ti kryer shërbimet një mujore një kompanie e cila ia heq bërlllogun prej shtëpisë. Për këtë ne e kemi analizuar që kjo çështje të adresohet te komuna dhe Kryetari i komunës ta merr për obligim që të merr vendim në asamble se cilat familje të trajtohen dhe të lirohen nga shërbimi komunal. Ndarja në zona është bazu në rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa për aktivitetin e bizneseve. Në këtë rregullore e kemi të ndara në zona dhe ne me kërkesën e përfaqësuesit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa ju kemi referuar atyre zonave të cilat janë në rregulloren për tarifa dhe në bazë të asaj edhe e kemi përcaktuar edhe tarifën për mbeturina.

Sanie Kuçi Rexhepaj - personalisht jam mundu me analizu këtë projekt-rregullore dhe në parim e shoh një përpjekje për me kriju një sistem më të strukturuar në menaxhimin e mbeturinave por aktualisht duhet me pranuar që nuk jemi përball një krize në mbledhjen e mbeturinave. Përkundrazi edhe nga ju kryesues u ngrit si pyetje çështja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe si qytetare nuk kam ankesa por as nuk kam ndëgjua ankesa nga qytetarët në mosfunksionim të sistemit aktual. Pse po hartohet pra kjo rregullore dhe çfarë qëllimi ka për deri sa sistemi aktual është komplet në rregull? Në këndvështrimin tim pasi e kam lexu rregulloren, e kam përmbledh në dy qëllime kryesore që rregullorja po i synon. Qëllimi i parë është që delegon më shumë kompetenca në nivel komunal për menaxhimin e sistemit dhe qëllimi i dytë është që rrit tarifat për ofrimin e këtij shërbimi. Te qëllimi i parë: delegon kompetencat te komuna. Në letër kjo mund të tingëllojë si një hap drejt një kontrolli më të madh të institucionit por mënyra se si është ndërtuar kjo rregullore, në praktikë rrezikon me kriju më shumë

paqartësi se sa zgjidhje.Dhe aktualisht sistemi i grumbullimit të mbeturinave realizohet nga Ekoregjioni kurse me këtë rregullore në disa raste përmendet edhe Ekoregjioni por më shumë në mënyrë formale se sa funksionale sepse me këtë rregullore grumbullimi parashihet të kryhet nga një kompani e licencuar pa qartësuar kush dhe si,dhe menaxhimi dhe mbukqyrja i kalon DSHPE konkretisht sektorit për menaxhimin e mbeturinave i cili sektor nuk ekziston.Ne po e ndërtojmë një sistem të ri mbi një strukturë që nuk e kemi.Madje përfshirja e disa akterëve paralelisht,drejtoria,sektori që mungon dhe Ekoregjioni po rrezikon me komplikue edhe ma shumë procesin.Në fund qytetari nuk e ka të qartë ku me u drejtu për një kërkesë më të thjeshtë.Po lidhem te neni 11.5 i rregullores: çdo person fizik apo juridik i cili për një periudhë të caktuar kohore nuk ka nevojë të marrë shërbim të grumbullimit të mbeturinave duhet të njoftoj paraprakisht me kërkesë sektorin për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Suharekës si dhe kompaninë Ekoregjioni,njesia punuese në Suharekë dhe të bashkangjes këto dokumente.Ne jemi duke kriju më shumë komplikim se sa zgjidhje për kërkesat më të thjeshta e leje më për ato që janë më të vështira.Personalisht jam skeptike në kapacitetin e komunës për me zbatu këtë rregullore.Jo në aspektin e dijës apo profesionalizmit të zyrtarëve aktual por në çështjen që a kemi njerëz dhe strukturë shtesë për me bo këtë çështje sepse nuk e kemi një sektor funksional,nuk kemi staf të dedikuar dhe kemi një rregullore që kërkon implementim të plotë Brenda një afati shumë të shkurtër kohor,duke filluar nga korriku i këtij viti dhe realisht në këtë gjendje aktuale me këtë projekt-rregullore kjo është e pamundur me u realizu.Qëllimi i dytë është rritja e tarifës për ofrimin e këtij shërbimi.Kur kërkohet më shumë pagesë nga qytetari duhet të jetë i qartë se çka përfiton ai në këmbim.Për shkak se nëse jemi duke synu një sistem më të mirë se ky që është,në këtë rregullore nuk mundemi me ofru.Nuk po rritet cilësia e shërbimit,po rritet vetëm tarifa.Nëse jeni duke synu me miratu një rregullore e cila në aspektin praktik shërbimi ka me vazhdu me funksionu qysh ka funksionu deri tani e jo si po thotë rregullorja por rregullorja me marrë vetëm ngritjen e tarifave.Atëherë na sillni një projekt-vendim i cili parasheh vetëm rritjen e tarifave e jo komplet ndryshimin e rregullores duke kriju një system i cili është vështirë me u realizu në kompetence totale të komunës dhe me përgjegjësi të cilat here i kalojnë ekoregjionit e here mbesin vetëm në përgjegjësi komunale.

Vlora Kryeziu - lidhur me këtë projekt-rregullore duke e pare se ka çështje se kërkojnë trajtim dhe përmirësim,dëshiroj të paraqes një propozim konkret dhe këtë propozim e kam përcjell në mënyrë zyrtare te Kryetari i komunës si ide për përmirësim të kësaj rregullore.Duke u bazuar në projekt-rregullore e cila përcakton edhe sistemin,mënyrën e grumbullimit të mbeturinave si dhe vendosjen dhe mirëmbajtjen e kontinierave,konsideroj se është e rëndësishme që kjo çështje të trajtohet edhe në aspektin e organizimit të tyre.Propozoj që gjatë planifikimit të vendosjes së kontinierëve në hapësirat publike të qytetit të shqyrtohet mundësia që ato të vendosen në hapësirat e posaqme dhe të mbuluara.Kjo do të ndihmonte në mbrojtjen e mjedisit,në ruajtjen e pastërtisë në hapësira publike,në zvogëlimin e përhapjes së mbeturinave si dhe në përmirësimin e pamjes së qytetit.Konsideroj se propozime të tilla konkrete mund të kontribuojnë në përmirësimin e kësaj rregullore sepse menaxhimi i mire i mbeturinave nuk është vetëm çështje pastërtie por është edhe çështje kulture dhe respekti për qytetarët tonë.

Avni Bytyqi - këto shqetësime që ti i ngrite besoj që janë të parapara në kuadër të planit për menaxhimin e mbeturinave.Planit i menaxhimit të mbeturinave i trajton të gjitha çështjet që ti i ke ngrit dhe i ke specifiku dhe mendoj që është e trajtuar dhe nuk ka nevojë të trajtohet në kuadër të kësaj rregullore.

Vlora Kryeziu - unë i kam lexu edhe ato nene për planifikimin e kontinierave dhe propozimi im ishte konkret që këto të jenë strevë,por presim.

Laureta Tafaj - fillimisht dua ti falenderoj në përulësi të gjithë punëtorët e pastrimit.Ajo që më bëri përshtypje ishte fakti që në këtë Asamble u tha diçka me të thëna e me të nine.Nuk funksionojmë në atë mënyrë,te ne në këtë vend funksionojmë me fakte.Këta që marrin social,i ka vërtetu dikush.

Besa Kuqi - dua të ju njoftoj se për momentin janë afërsit 319 raste sociale në komunën e Suharekës dhe është e vërtetë ajo që tha Laureta,që ato i mbukqyr dikush dhe raporton për ato raste.Nëse e ka pas një kerr në oborr dikush,nuk është aq problem sepse ka mujt me huazu prej dikujt.Një nënë që është vetushqyese,që i ka vdek burri dhe që duhet me jetu prap dhe duhet ata fëmijë me i shkollu,nuk ka kurgja të keqe nëse e ka pas një kerr në oborr.

Dardan Berisha - ne sot po e diskutojmë një çështje shumë me rëndësi,çështja e rregullores,rregullore e cila ka qenë dy herë mandatin e kaluar dhe nuk ka kalu.Mirëpo ne sot po e diskutojmë një çështje shumë me rëndësi,çështje e cila pa prejashtim menaxhimi i mbeturinave dhe rregullores së re që synon përmirësimin në shërbim dhe në komunitetin tonë.Një qytet i pastër nuk është vetëm çështje estetike por është çështje shëndeti publik,dinjiteti dhe përgjegjësie qytetare.Rregullorja e re nuk është hartuar

për të rënduar qytetarët por për të vendosur rend,përgjegjësi dhe qëdrueshmëri në një sektor që për vite me radhë ka pasur sfida të mëdha.Ajo synon të krijoj një sistem funksional të drejtë dhe efikas ku secili kontribon sipas mundësive dhe përfiton një shërbim cilësor.Një nga pikat më të diskutuara deri tash të kësaj rregullore është rritja e tarifave,sidomos për amvisëri nga 4.5€ në 6€.E kuptojmë se çdo rritje financiare ngjall shqetësim dhe është e drejtë që qytetarët të kërkojnë llogari por le ta shohim këtë çështje me realizim dhe përgjegjësi.Kostoja e shërbimeve është rritur ndjeshëm ku diskutuan edhe parafolësit.Pra çmimet e karboranteve,mirëmbajtja e automjeteve,paisjeve,si dhe shpenzimet operative janë shumë më të larta se më pare.Për më tepër kërkesat për standarte më të larta të pastërtisë dhe mbrojtjes së mjedisit janë rritur.Në këtë kontekst kjo rritje prej 1.50€ nuk është një barrë e pajustificuar për një investim të domosdoshëm për një shërbim më të mirë.Një mjedis i pastër nuk ka çmim por ka kosto dhe kjo kosto duhet të ndahet në mënyrë të drejtë.Në veqanti sot do të ndalemi dhe shprehim mbështetjen dhe respektin për punëtorët e Ekoregjionit.Ata janë njerëzit që çdo ditë punojmë në kushte jo gjithmonë të lehta,kujdesen për pastërtinë e qytetit dhe fshatrave tonë.Është detyrë e jona si shoqëri ti mbrojmë dhe ti mbështesim këta punëtor.Rritja e tarifës,konkretisht edhe rregullores dhe kalimi i rregullores,kontribon drejtëpërdrejtë edhe në përmirësimin e kushteve të tyre dhe në funksionimin më të mirë të ndërmarrjes.Andaj duke e mbështetur këtë rregullore ne po e mbështesim jo vetëm një system më të mirë të menaxhimit të mbeturinave por edhe dinjitetin e punës. Unë e kam cek edhe në KPF,të gjitha qytetet e regjionit tarifën e kanë të rritur qysh kur ka ardhë Jica.Për me pas një menaxhim më të mirëfilltë të mbeturinave ne duhet ta kalojmë dhe unë kërkoj prej të gjithë kolegëve asambleist që kjo rregullore sot ta marrë dritën e gjelbër dhe të njejtën kohë nëse shohim mundësinë e ndryshimit të ndonjë pike të veçantë në të kaluarën,mund ta ndryshojmë në kuvend.

Flamur Bytyçi - u përmend edhe më herët dhe e pata pyetje se pse nuk del me raportu përfaqësuesi jonë në Ekoregjion dhe me na tregu pak a shumë gjendjen sepse edhe kërkesa ka ardhë prej Ekoregjionit për m'u rrit tarifa.Prej kohës sa ne jemi aksionar,sa kemi obligime dhe kur e kanë bërë propozimin a e kanë parapa që ka m'u rrit edhe paga minimale?A duhet prap ne me ndryshu këtë çmimore në të ardhmen apo janë të parapara të gjitha gjërat këtu?

Kryesuesi - ne e kemi zyrtarin kryesor të Ekoregjionit dhe në qoftëse është i gatshëm,unë do t'ia kaloj fjalën që ta pasqyroj situatën se si është.

Liridon Fandaj - shumë mire që kryeshefi ka me raportu këtu por ne e kemi një anëtar të bordit në Ekoregjion dhe asnjëherë nuk e ka sjell asnjë raport dhe ai do të duhej të raportonte për njesinë tonë dhe për të dhënat e njesë tone.Unë e kam ngrit si shqetësim edhe herën e kaluar që komisioni nuk ka raportu.

Kryesuesi - shpresoj që në të ardhmen do të vijmë me një raport,do t'ia kërkoj edhe unë.

Burim Shala - Kryeshefi i kompanisë Ekoregjioni raporton sa i përket kësaj kompanie.Në vitin 2021 pagat e punëtorëve kanë qenë rreth 314€ dhe sot e kalojnë edhe ligjin që është aprovu për pagën minimale dhe e kemi bërë 495€ pagën bazë ku prej muajit korrik prej se të hyn ligji në fuqi ngritet nga 5€.Sa i përket rregullores pagat e punëtorëve i vendos menaxhmenti e Ekoregjionit dhe nuk ka të drejtë në bazë të ligjit të vendos Asambleja komunale sepse bie në kundërshtim me ligjin e ndërmarrjes publike.Tek nafta arsyetimin që e kemi bërë ne është që kosto e tarifave që neve na kushton për amvisëri është 6.18€ që i kushton kompanisë me shku nëpër shtëpi m'i marrë mbeturinat.Komuna e Suharekës është e vetmja komunë në Kosovë që nuk ka bërë asnjë ndërrim të tarifave prej se ka ekzistuar kompania e Ekoregjionit ndërsa sa i përket Rahovecit dhe Gjakovës,Rahoveci e ka 6€ para 3 viteve dhe tani Rahoveci tarifën do ta bëjë 8€.Shtimja e ka tarifën 6.5€ qe 3 vite ndërsa Suhareka e ka ende 4.5€.Në vitin 2021 nafta ka qenë 0.89€ ndërsa sot nafat është 1.55 €,pra 47,000.00€ është më shumë vetëm nafta në komunën e Suharekës.Sa i përket deponisë në vitin 2021 kemi pagu 144,000.00 deponi në Landovicë vetëm për komunën e Suharekës ndërsa sot paguajmë 256,000.00€.Në total vetëm 3 komponentë si rroga,KMDK-ja dhe nafta kanë ndryshuar në vit 283,000.65€ njesia Suharekë që paguan më shumë për këto tre komponentët.Kompania e cila është njesi e Suharekës borxhin që i ka njesive tjera në vitin 2024 është 50,000.00€ borgj,në vitin 2025 kompania ka dale me 90,000.00€ borgj dhe në vitin 2026 kompania pritet të dal me 130,000.00 € borgj që i detyrohet njesive tjera sepse nga njesitë tjera paguhet komuna e Suharekës.Arsyeja pse?sepse të gjitha komunat kanë bërë rritje dhe e vetmja komuna e Suharekës nuk ka bërë rritje.Ne kemi kërku tarifën 7.5€ nëpër të gjitha komunat dhe tarifata do të kalojnë 7.5€.Nëse vazhdohet me këto tarifa,edhe 6€,unë them që përsëri pas një viti keni me u mbledh ju për ti rishiku sepse ne si kompani nuk mund të kryejmë shërbime.Sa i përket rasteve sociale,është bërë një propozim në komuna e Dragashit që ti heq nga pagesa rastet sociale por është e ndaluar me ligj sepse

një kompani që ofron shërbime e ka të ndaluar ti heq nga pagesa dhe këtë mund ta bëj vetëm komuna nëse e subvencionon kompaninë për aq sa ka raste sociale.

Liridon Fandaj - te pjesa e pagave ti the që njesia Suharekës i kanë pagat më të mëdhaja se njesitë tjera. Nuk e di që vlera e pagave të njesjës tonë është më e madhe! Cila është garancia jote që nëse ne e miratojmë këtë rregullore dhe ju si kompani keni me marrë tenderin prapë për mirëmbajtje pasi që ligji për prokurim publik nuk të favorizon ty si kompani por janë të barabartë secila kompani? A keni ju si kompani marrëveshje edhe me fshatrat për mbledhjen e mbeturinave apo keni veq me komunën dhe komuna ju jep atë të drejtë?

Burim Shala - e thash që pagat kanë qenë 314€ ndërsa janë 494€, janë rrit për të gjithë punëtorët e kompanisë Ekoregjioni përfshirë dhe Suharekën. Sa i përket marrëveshjes a kemi me fshatra, ligji e përcakton mirë ku secili qytetar në bazë të rregullores komunale obligohet të paguaj mbeturina dhe nuk ka nevojë kontratë individuale. Kompania Ekoregjioni dhe ndërmarrjet tjera publike nuk i nënshtrohen ligjit të prokurimit publik por është me marrëveshje e cila quhet kontratë në shtëpi dhe bëhet një marrëveshje direkt mes meje dhe Kryetarit të komunës. Unë e kam me 5 komunat marrëvejen që bëjmë kontratë sipas ligjit të prokurimit publik neni 4 e parasheh.

Flamur Bytyçi - vlera 200,000.00 për cilën periudhë kohore është? Sa ka obligime tjera Ekoregjioni? A ka obligime tjera në ATK ose obligime tjera ndaj operatorëve tjerë?

Burim Shala - borgjin që e ceka unë është i vitit 2024 50,000.00€, i vitit 2025 90,000.00€ dhe është një borgj ndaj administratës tatimore 46.00€ për kohët e fundit që nuk është paguar, rreth 200,000.00€, plus 120,000.00€ është në plan biznesi i vitit 2026 që është parapa që komuna e Suharekës ka me qenë borgj me këto tarifa dhe shpenzime të krahasuar me vitin 2025. Sa i përket borgjit të ATK-së ju e dini që kompania e Ekoregjonit inkasimin në komunën e Suharekës e ka pas rreth 50% apo 60% dhe sot qytetarët janë shumë të kënaqur dhe inkasimi është mbi 99% sidomos 3 vitet e fundit. Sa i përket ATK-së kompania e Ekoregjonit në nivel të regjionit të 5 komunave ka pas borgj edhe 4,800,00.00€ ku nuk janë pagu as taksat e punëtorëve në atë kohë dhe në vitin 2021 kur kam ardhë unë e kam bërë një marrëveshje me ATK 10 vjeqare ku është paguar një tarifë prej 35,000.00€ ku kemi arrit ta paguajmë ndëshkimin komplet dhe tani momentalisht kemi borgj rreth 2,000,000.00€ ndaj ATK-së deri në vitin 2031 kompania e paguan një tarifë 35,000.00 mujore. Ky borgj është prej mbas lufte deri më sot i akumuluar deri në vitin 2021 ndërsa qytetarët e Suharekës i kanë borgj kompanisë rreth 1,000,000.00€. Nga viti 2022 unë si kryeshef e kam marrë një vendim ku i kemi qu mbi 2,000.00€ familje në përmbarues dhe të gjithë kanë arritur me bërë një marrëveshje me kompaninë dhe andaj ka ardhë inkasimi shumë i mire.

Labinot Halitjaha - në parim jam për me kalu këtë pikë por dua ti bëj tri pyetje. Kush vendos për rritjen e pagave të punëtorëve të Ekoregjonit? Nëse komuna e Suharekës nuk bën pagesën e borgjit që e kemi në Ekoregjon, kush e merr vendimin dhe a ka mundësi me u tërheq Ekoregjin për shërbim dhe pastrim që e bën? The që inkasimi është më i madh, rreth 95% nga komuna e Suharekës ndërsa nuk e di sa është inkasimi në komunat tjera. Nëse është inkasimi 95% i bie që Suhareka ka kontribut të madh në pagesa ndërsa komunat tjera kanë me 50% ose 60%.

Burim Shala - propozimi për rritje të pagave gjithmonë bëhet nga menaxhmenti duke e bërë raportin e anëtarëve të bordit pastaj bordi mund të vendos edhe me aksionarët. Sa i përket komunave tjera inkasimi është i kënaqshëm ku në të gjitha komunat është 98%, në Prizren është 100% për shkak se në Prizren inkasimin e bën komuna dhe nga korriku ne kemi kërku që inkasimin ta marrim ne si Ekoregjon. Borgjin që e the, ne po flasim vetëm për raportin e Suharekës sepse Ekoregjioni vepron për 5 komuna për raportin financiar dhe shpenzimet i ka të ndara. Komuna e Suharekës nuk paguan asnjëherë asnjë mekanikë dhe të gjitha i paguan komuna e Prizrenit. Kryeshefi tutje jep sqarime.

Visar Kuçi - fole për borgjin në komunën e Suharekës dhe the që inkasimi në komunën e Suharekës është 95% ,sa është përqindja e shërbimeve në territorin e komunës së Suharekës?

Burim Shala - shërbimi është 100%.

Visar Kuçi - borgjet janë akumuluar si rrjedhojë e tarifës së vogël. Nëse ne nuk e rrisim këtë tarifë, a i ndërpret shërbimet Ekoregjioni apo mund të zvogëlohen shërbimet?

Burim Shala - nëse kjo tarifë nuk rritete kompania Ekoregjonit, njesia Suharekë shumë shpejt shkon pranë falimentimit dhe kompania e Ekoregjonit nuk mund të kryej shërbim në komunën e Suharekës sepse komunat tjera nuk kanë interes të paguajnë para për komunat tjera. Nëse ne i kemi bërë rreth 180 anketa me qytetarët, ata janë të kënaqur me shërbimet dhe janë pro rritjes së tarifave. Suhareka e ka edhe një problem sepse mbi 50% janë jo rezidentë.

Visar Kuçi - meqenëse janë 50% jorezidentë, a i kryejnë obligimet?

Burim Shala - është tarifa në bazë të rregullores. 3-4 vitet e fundit qytetarët nuk kanë borgje.

Sanie Kuçi Rexhepaj - përmendet që një nen i ligjit për prokurim publik ju mundëson që ju me komunën si ndërmarrje publike me realizu një marrëveshje për kryerjen e këtij shërbimi. Çka nëse licencohet Eko Theranda? A po krijohet një konkurrencë në këtë shërbim për shkak se nëse Eko Theranda licencohet është 100% aksionar komuna e Suharekës ndërsa në Ekoregjion është 13.1%. Kjo rregullore përveq ndryshimit të tarifave parashih dhe një ndërrim të sistemit të funksionimit të këtij shërbimi ku e ceka edhe në fjalimin që e pata ku nga korriku e tutje çështjen e sistemit të grumbullimit të mbeturinave nuk e menaxhon më Ekoregjioni por e menaxhon komuna e Suharekës e cila në fakt nuk ka sektor për menaxhimin e këtij sistemi. Cili është qëndrimi juaj karshi kësaj dhe pse po kërkon që ne me miratim rregulloren në të cilën ju vet keni me pas ndoshta komplikime në zbatim të kësaj?

Burim Shala - secila komunë e ka obligim ligjor me të një rregullore për mbeturina pastaj ekzekutimin e rregullores e implementojmë ne me mbikqyrjen e komunës. Ne i raportojmë edhe Drejtorisë për Shërbime Publike sa i përket AMMK-së kur të raportohet, i dërgojmë të dhënat edhe kësaj derjtorie. Sa i përket çështjes së mbeturinave a rrezikohet Ekoregjioni nga Eko Theranda, sipas ligjeve në fuqi një ndërmarrje është me një komunë, nuk ekziston një ndërmarrje tjetër për mbledhjen e mbeturinave sepse bie ndesh me ligjet në fuqi. Kryeshefi tutje jep sqarime.

Avni Bytyqi - komuna jonë ka kontratë me Ekoregjionin për ofrimin e shërbimeve dhe me sa di unë kontratat për shërbimin e këtyre çështjeve janë kontrata kornizë tre vjeqare dhe për aq kohë sa e kemi kontratën tre vjeqare, kemi obligim ta përmbushim atë kontratë. Mirëpo sipas takimit që e kam pas në konsultim me Kryetarin ne jemi në procedurë e sipër me kryeshefin ekzekutiv të ndërmarrjes Eko Theranda që ndërmarrjen tonë ta fuqizojmë dhe ta licencojmë për çështjen e menaxhimit të mbeturinave dhe nga ai moment që ndërmarrja jonë fuqizohet dhe licencohet atëherë çështjen e menaxhimit të mbeturinave ka me marrë Eko Theranda dhe ne si komunë kemi me inicuar procedurën dhe me u shkëput nga Ekoregjioni. A lejohet apo nuk lejohet, janë çështjet kompetente të cilat vendosin më tutje. Për këtë arsye edhe e kemi themelur me ndihmën dhe vendimet e këtij Kuvendi dhe me rregullimin e infrastruktures ligjore të këtij Kuvendi.

Sanie Kuçi Rexhepaj - për mendimin tim, për momentin duke paraparë që rregullorja hyn në fuqi nga korriku i këtij viti, komuna e Suharekës nuk e ka kapacitetin as të zyrtarëve që me realizu këtë rregullore. Për atë arsye edhe qëndrimi jonë karshi kësaj rregullore është kundër, jo përkundër tarifave por formës së funksionimit të kësaj rregullore.

Urim Suka - unë e falemderoj kryeshefin për të gjitha sqarimet, sqarime që ne nuk i kemi ditë dhe kjo është përgjegjësi e përfaqësuesve tonë atje apo edhe si kryeshef keni përgjegjësi, pse ne në baza të rregullta nuk informohemi për këtë gjendje. Ajo që me shqetëson është se këtu për të na raportuar është dashtë të jetë përfaqësuesi jonë dhe shumë më herët me na informu që ne me i pas qëndrimet edhe më të përgjegjshme në qoftëse ka bazë të arsyeshme. Ne nuk po flasim këtu për Ekoregjionin po flasim për një rregullore që rregullon më shumë se sa Ekoregjioni. Mbi bazën e vërejtjeve që ne kemi bërë, ne nuk mundemi me i dhënë mbështetje kësaj rregullore.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

11 për, 14 kundër, Nuk miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale „Eko Theranda“;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe kërkon propozimet nga subjektet politike.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit propozoj Bexhet Kuçi.

Astrit Salihu - nga grupi i LDK-së propozojmë Nexhat Ramadanin i cili ka qenë edhe drejtor në këtë lami dhe ne mendojmë që mund të jep një kontribut të mirë në këtë komision.

Dardan Berisha - grupi i PDK-së propozon Labinot Halitjaha.

Laureta Tafaj - LVV nuk ka propozim.

Kryesuesi - NISMA nuk qenka prezente. E hedh në votim propozimin për Bexhet Kuçin.

13 për, 11 apstenime.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Nexhat Ramadanin.

9 për,1 kundër,12 apstenime.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Labinot Halitjahën.

13 për,12 apstenime.

Kryesuesi konstaton që në këtë komision me shumicë të votave shkojnë Bexhet Kuçi dhe Labinot Halitjaha.

Nënkryetarja - në emër të Kryetarit të komunës për këtë komision emërojmë Albulena Kokollari.Si ekologe që është me profesion mendojmë që është person i duhur.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Bexhet Kuçi,Labinot Halitjaha dhe Albulena Kokollari.

13 për,11 kundër,Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - mendoj që kur një kontratë përmbillet është obligim i komunës paraprakisht me i fillu procedurat para se me u kry afati,me bë zgjedhjen dhe me u vazhdu afati apo me gjet operatorë tjerë.Ajo që pak më çudit ose që kisha dasht me pas,për deri sa ne po vendosim për një lokal dhe për deri sa po përmbillet një kontratë 10 vjeqare,do të ishte mire ne me qenë të informuar për rrjedhojën e mbylljes së asaj kontrate.Me sa unë kam informacion aty është një librari e cila kryen funksione dhe operator i ka kryer obligimet.Tash me pëlqimin që ne e japim ai duhet me lëshu atë objekt dhe me rikonkuru prapë nëse don me marrë.Nëse ky person ka qenë i përgjegjshëm,te ligji për dhënie në shfrytëzim te pronat afatgjata,e lejon që me performacë me u vazhdu nëse performanca ka qenë e mirë.Lus zyrtarin ligjor të jep sarime që a kish pas mundësi që me vlerësim të performances me na ardhë sot si rekomandim për me ia vazhdu dhe nëse nuk e ka këtë mundësi,a ban si komunë me bë propozim edhe ligji ndoshta me u ndryshu për në të ardhmen me u rregullu këto çështje pak ma mire që nëse është një biznes i cili po funksionon atje mos me detyru me përdor ankandin vazhdimisht dhe rekomandimi me ardhë me një qira mbi bazën e tregut tash.A është baza ligjore me shku në këtë formë? Nëse nuk është ne e ndjekim procedurën por mujna me kriju probleme dhe normal jemi për me dhënë edhe pëlqimin që me u inicu nëse ka mbet pa kontratë.

Kryesuesi - pajtohem me ty dhe pikërisht bëhet fjalë për lokalin e Edorit dhe është shumë i përgjegjshëm por procedurat lgjore e kërkojnë me i vazhdu procedurat për dhënie në shfrytëzim.

Avni Bytyqi - ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës është në procedure të plotësim-ndryshimit dhe unë jam në grup punues me vendim të qeverisë.Është e vërtetë që një dispozitë ligjore e ligjit thotë aty që me performacë mundësohet me vazhdu kontratën për kontratat afatgjata.Nëse është miratu në Kuvend ky ligj,tek pastaj e kemi vërejt ne që ka qenë një lëshim.Është bërë fjalë për kontratat afatshkurtra sepse nuk ka kuptim kontrata afatgjatë të vazhdohet me performacë sepse janë periudha 99 vjeqare.Kështu është dhe më nuk mund të ndryshojmë asgjë tjetër ndërsa në procedurën e plotësim-ndryshimit të këtij ligji ne e kemi parasysh dhe këtë dispozitë ligjore do ta shëndrojmë nga kontratat afatgjata në kontrata afatmesme.Në këtë rast ne duhet ti përmbahemi ligjit dhe e kemi obligim që ti zhvillojë procedurat e ankandit publik.

Liridon Fandaj - ne jemi për me mbështet këtë projekt-vendim.Kjo pronë a është e publikuar në listen e pronave për dhënie në shfrytëzim?

Mensur Selimaj - po është e publikuar për shkak se ministria e ka shty afatin deri me 31 mars dhe është e publikuar konform rregullave të ligjit në fuqi.

Urim Suka - sa e kuptova këtë vit e ke fut.Sa e di unë ligjin,publikimet duht të bëhen 1 vit përpara.

Avni Bytyqi - ajo që e tha drejtori është ashtu.Qeveria din me punu edhe në kundërshtim me ligjin për arye as ata s'kanë pas të drejtë me marrë vendim në kundërshtim me ligjin me azhdu afatin sepse ligji është shumë i qartë ku thotë deri me 31.12 viti aktual mirëpo e ka kriju këtë mundësi me qëllimin që komunat kanë qenë në zgjedhje.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën, hap debatin dhe kërkon propozimet.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ky komision a ka të drejtë me vazhdu procedurën që ata kanë mbet përgjysmë apo duhet me fillu prej fillimit shpalljen e konkurimit të hapur? Për arsye sepse po ndërlihem me pikën e rendit të ditës që na sollët dhe me vendimin e ministrisë ku për çështjen e banesave të kompanisë Mobelland kërkoi që me fillu edhe një here konkurimi i hapur nga zero.

Avni Bytyqi - siq e tha Kryesuesi në qershor është pezullu procedura për shkak të shpalljes së zgjedhjeve dhe ligji e ndalon një gjë të tillë në momentin kur shpallen zgjedhjet por nuk e sqaron më tutje se çka dhe në analogji kemi shku ne që le të jetë në kompetencën tuaj dhe mandatin tuaj ku kemi dy mundësi. Mundësia e parë është që të formohet komisioni dhe të vazhdohet puna aty ku ka mbet dhe mundësia e dytë është që të ktheheni ju si Kuvend në pikën zero.

Sanie Kuçi Rexhepaj - duke pas parasysh që komisioni i kaluar është themelmu në 30 maj 2024 dhe lind natyrshëm pyetja se pse nuk është përfundu puna e komisionit?

Armend Krasniqi - unë kam qenë kryesues i këtij komisioni dhe i kemi përfunduar të gjitha procedurat dhe në ditën që presidentja e Republikës së Kosovës i ka shpallur zgjedhjet, ne po atë ditë e kemi shpallur edhe rezultatin fituesve të këtyre banesave. Ne e kemi shpallur paradite, ajo i ka shpallur zgjedhjet pasdite dhe kemi ardhë në një problematikë që nuk kemi ditë se si të veprohet më tutje. Ndërsa duke u konsultuar me zyrtarin ligjor dhe ekspertë të ndryshëm, rekomandohet që ky komision i cili ka qenë paraprakisht nuk ka mujt me përfundu punën deri në fund.

Urim Suka - drejtorja bashkë me komisionin mbi një vit ka pas kohë dhe është dasht paradite se me u shpall zgjedhjet këta me marrë vendimin. Janë vonu si drejtori dhe është e papërgjegjshme. Për këto banesa ne e dimë si ka ardhë lënda deri këtu por ne sot e dime edhe sa obligime tjera ka komuna dhe as një veprim nuk e merr. Vetëm këto familje është dasht me i hek prej banesave dhe krejt borgjlinjtë tjerë sot po funksionojnë normal. Është veprim selektiv dhe veprim jo njerëzor që ti po merr një vendim sepse po të ishte për krejtë unë ju kisha falemderu.

Armend Krasniqi - është e vërtetë që kemi zhvillu procedurë konform ligjeve dhe rregulloreve të cilat i ka pas drejtorja në atë kohë mirëpo pse ka zgjat një vit është se komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve. Anëtarët vendosin dhe nuk ka asnjë komision afat të caktuar nga Kryetari i Komunës apo Asambleja se kur me u përfundu. Ne për shkak të punëve të shumta të cilat i kam pas, për shkak se kam qenë mbi tri menaxhime të kontratave të shërbimeve publike dhe për shkak se kam pas shumë punë në Drejtorinë e Pronës, mirëpo gjat rrugës ka pasur edhe procedura të cilat na kanë ardhur si pikëpyetje duke kundërshtuar fuqishëm ata njerëz të cilët i kemi hequr nga banesa dhe kemi pritur një vendim nga zyra ligjore dhe kemi pas edhe gjëra tjera gjatë rrugës ku për atë arsye ka ndodh një vonesë e këtij komisioni mirëpo vonesa nuk na diskualifikon me ndonjë ligj apo rregullore.

Aziz Bytyqi - propozojmë Enver Shabani.

Dafina Kolgeci - propozojmë Astrit Salihu.

Dardan Berisha - propozojmë Demokrat Vataj.

Atigona Zyba - LVV nuk ka propozim.

Jehona Rrafshi Lumi - Nuk ka propozim.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Enver Shabanin.

14 për, 11 apstenime.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Astrit Salihu.

9 për, 5 kundër, 9 apstenime.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Demokrat Vataj.

14 për, 1 kundër, 12 apstenime.

Kryesuesi konstaton që me shumicë të votave në këtë komision shkojnë Enver Shabani dhe Demokrat Vataj.

Nënkryetarja - nga ekzekutivi për këtë komision propozojmë Armend Krasniqi, Lindita Berisha dhe nga OJQ Erëza Muqa.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Enver Shabani, Demokrat Vataj, Armend Krasniqi, Lindita Berisha dhe Erëza Muqa.

14 për, 11 kundër, Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe kërkon propozimet nga subjektet politike.

Sanie Kuçi Rexhepaj - meqenëse kemi të bëjmë prap me një procedure të pezulluar në mandatin e kaluar për shkak të vendimit të Presidentes dhe drejtori tha që për çështjen paraprake na paradite veq kemi marrë vendim,pasdite ka marrë Presidentja vendim për pezullim të këtyre procedurave me ironi, a ka procedura të tjera kryesues të cilat kanë qenë në procedure në mandatin e kaluar dhe kanë me u bartë prap në këtë mandat për vazhdim të procedurave që kanë lënë pezull komisionet e kaluara?

Armend Krasniqi - nuk e thash me ironi por e thashë me saktësi atë çka ka ndodh gjatë rrugës së komisionit.Ndërsa një procedure tjetër e cila ka mbetur te rasti i Agit,nuk ka qenë në kompetencën e drejtorisë së pronës por ka qenë kompetencë e Asamblesë dhe Kryetarit.

Sanie Kuçi Rexhepaj - pse po thua që ka qenë në kopetencën e Kuvendit për arsye se komisioni ka qenë i formuar nga Kuvendi?Nëse komisioni nuk ka pas mundësi me realizu punën e vet,është dasht me raportu në Kuvend.

Armend Krasniqi - kemi qenë sëbashku në atë komision,kemi punuar deri në përfundim mirëpo për shkak të mos mbledhjes së komisionit të atëhershëm ka ndodhur dorëheqja juaj,mandej ka ardhë edhe një here dhe u formu dhe pas formimit të komisionit tjetër nuk ka arrit me u kry ajo procedure dhe besoj tash pasi të formohet komisioni tjetër dhe e përfundon punën me sukses.

Aziz Bytyqi - propozojmë Edon Sadikaj.

Flamur Bytyçi - propozojmë Dafina Kolgeci.

Dardan Berisha - propozojmë Labinot Halitjaha.

Antigona Zyba - LVV nuk ka propozim.

Jehona Rrafshi Lumi - NISMA nuk ka propozim.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Edon Sadikaj.

14 për,12 apstenime.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Dfina Kolgecin.

8 për,12 apstenime.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Labinot Halitjaha.

14 për,12 apstenime.

Kryesuesi konstaton që me shumicë të votave në këtë komision shkojnë Edon Sadikaj dhe Labinot Halitjaha.

Nënkryetarja - nga ekzekutivi në këtë komision propozojmë Armend Krasniqi,Ardita Kolgeci dhe nga OJQ Herolinda Zenelaj.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Edon Sadikaj,Labinot Halitjaha,Armend Krasniqi,Ardita Kolgeci dhe Herolinda Zenelaj.

14 për,12 kundër,Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të komunës për ndarjen e mjeteve financiare;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 7.

Unanimisht Miratohet pika 7

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi - mbledhjen e kaluar pata kërkuar sqarime prej Kryetarit për mënyrën e përzgjedhjeve prej disa prej anëtarëve dhe të njejtën kohë dua të di që a janë përfshirë të gjitha komitetet fetare meqenëse njëra prej tyre ka një ankesë që nuk është e përfshirë,komiteti protestantë.Pse nuk janë të përfaqësuar në këshill?

Avni Bytyqi - udhëzimi administrative decidivisht e thotë: nga një përfaqësues legjitim i secilit bashkësi fetare. Komuniteti protestant në komunën tonë nuk është bashkësi fetare.

Flamur Bytyqi - pyetjet që ne i bëjmë kur kërkojmë diçka prej drejtorave, a e kanë obligim ligjor patjetër apo duhet ne me bë kërkesë me shkrim dhe me u sjell raportet të cilat ne i kërkojmë.

Avni Bytyqi - pyetjet që i bëni drejtëpërdrejtë Kryetarit apo drejtorave, realisht nëse drejtori dhe Kryetari është i gatshëm të përgjigjet aty për aty, kryhet përgjigjja por nëse Kryetari apo drejtorat nuk janë të gatshëm të përgjigjen aty për aty, kanë obligim ligjor që mbledhjen e radhës t'ju raportojnë apo t'ju informojnë për pyetjen që ju e keni bë. Nëse ti kërkon raport dhe konstatohet në procesverbal është kërkesë zyrtare.

Urim Suka - nuk jam ekspert se si bëhet një plan por kur e lexova këtë plan nuk më pëlqej. Për me hartu këtë plan, sa takime janë mbajtur? A ka pas ndonjë komision të caktuar? Kush e ka hartu këtë plan? A ka një procesverbal se si është hartu ky plan? Nëse ka pas një komision është dasht pak ma përgjegjshëm me qenë sepse kur flasim për sigurinë është puna e parë sepse po s'kemi të sigurtë, kurrë një tjetër nuk na duhet. Serioziteti te temat e sigurisë duhet me qenë numër 1.

Avni Bytyqi - Kryetari i komunës është kryesues i KKSB-së ndërsa unë me vendim të Kryetarit jam kordinator. Në takimet e fundit që i kemi pas me Kryetarin, komandantin e policisë dhe me përfaqësues të FSK-së që unë kam komunikuar me autorizimin e Kryetarit të komunës, ne e kemi hartu këtë plan të punës për KKSB-në për periudhën prill-dhjetor 2026 dhe me kërkesën e tyre ne i kemi parapa këto aktivitete, çështje që duhet të trajtohen me qëllim të rekomandimeve për çështje të sigurisë dhe Kuvendi nëse ka nevojë të merr vendime dhe ti ekzekutoj ekzekutivi. Për hartimin e planit të punës mund të mbahet vetëm një takim ku vijmë propozimet konkrete sikur që ju sot mund ta jepni një propozim konkret dhe unë patjetër e fus në kuadër të këtij plani. Një takim e kemi pas dhe i kemi vendosur çështjet në letër.

Kryesuesi - nëse keni ndonjë propozim të mirë për në plan pune në KKSB, mund ta jepni. E hedh në votim pikën 8.

12 për, 6 apstenime, Miratohet pika 8.

Pika 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-9877;

Kryesuesi - elaron pikën dhe kërkon që të shfuqizohet kjo pikë.

Urim Suka - nëse ju kujtohet, kur kemi diskutuar atëherë për me miratu këtë projekt-vendim, kërkesa jonë specifike ka qenë që mos ta miratojmë me kërkesën që nuk po e mbron interesin qytetar si duhet dhe e kthejmë në pikën zero dhe le të fillon pastaj procedura edhe se si parashihet në HZK. Nuk na keni dëgju atëherë dhe tash detyrohemi me shfuqizuar një vendim. Normalisht që jemi opozitë dhe kemi me ju kritikuar por kemi shumë dëshirë me pas bashkëpunim që komunës mos me ju dasht me shfuqizuar çdo seance nga një apo dy projektvendime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 9.

Unanimisht Miratohet pika 9

Pika 10. Diskutim për çështjen e heqjes së fotografisë së ish Kryetarit Ukë Bytyqi nga zyra;

Kryesuesi - hap debatin për këtë pikë dhe ju lus të jeni më të matur.

Nexhat Ramadani - besoj që ne jemi të vetëdijshëm por do të ishte mirë që ne të jemi të vetëdijshëm kur ne të veprojmë. Ne nuk kemi dasht me ngrit këtë çështje por ajo që na ka nxit është se kemi informacione që ajo që ka ndodh ka mbi një javë dhe kemi prit që do të ketë një veprim edhe nga ana e Kryetarit. Kur kemi pa që s'ka kurrëfar veprimi që nuk ka të bëjë vetëm me figurën e ish Kryetarit Ukë Bytyqit e cila është një figurë e respektuar jo vetëm në nivel lokal por edhe në nivel nacional dhe mos marrja e asnjë veprimi nga Kryetari i cili thirret shpesh edhe si shok i tij, na ka detyruar që ta diskutojmë dhe të shohim se çka ka ndodh aty. Nuk gëzohemi që ka ndodh ky veprim i tillë, nuk themi që e kanë bë qëllimisht dhe për këtë po diskutojmë. Ne fillimisht e denojmë si akt dhe uroj që mos t'jetë politikë por që fatkeqësisht duket i tillë. Uroj që çdo kush kur të merr vendim është mirë që ti peshoj veprimet. Për deri sa ka qenë një fotografi atje, të analizojë një herë pse është kjo fotografi këtu. A ka ndonjë vendim për me vendosur këtë? Është një figurë që i kalon përmasat politike andaj kjo është goditje për figurën e Ukë Bytyqit, është një vendim i familjes pastaj edhe i gjithë qytetarëve të komunës të cilët në një formë

e dinë për kontributin dhe respektin që kanë për figurën e Ukës. Ajo që neve më së shumti na ka shqetësuar është që Kryetari i komunës ka pas informacione dhe nuk ka marrë kurrëfarë veprimi deri më tash. Nuk duhet ndonjë procedurë e veçantë që të merret veprimi lidhur me këtë çështje. Është dashtë të trajtohet urgjentisht para se të bëhet diçka publike. Nuk na vje mire neve që në portale del lajmi që u hoq fotografia e Ukës dhe për këtë nuk e kemi ngrit menjëherë këtë çështje sepse kemi menduar që është dashtë dikush me marrë masa dhe mos me bë këtë çështje politike. Ne nuk po e bëjmë politike. Politike po e bëni ju me veprimet e juaja apo me mos veprimet e Kryetarit, i cili në moment të caktuara kur i duhet për interesa politike e përdor pikërisht këtë figure, ndërsa tash kur do të duhej jo vetëm për figurën e Ukës por të vendos për me e rizbatu një vendim që e ka marrë pikërisht ky institucion. Ne kemi një vendim që ka marrë kuvendi i komunës ku e ka shpallur ish Kryetarin e komunës Kryetar nderi të komunës dhe ka përcaktuar me nene të caktuara në cilat zyre duhet të jetë fotografia e Ukës. Ne urojmë që të mos përsëritet asnjëherë më një akt i tillë dhe sa më shpejt që të merren veprime të duhura konform asaj që është marrë me vendim të kuvendit të komunës.

Amir Hoxha - ligjin për symbol kombëtar dhe rregulloren e protokollit për mbarëvajtjen e zyreve, asnjëra prej tyre nuk më ka shty me hek atë fotografi. Nëse dikush don me trajtu politikisht këtë punë për poena dhe për tik tok, merruni gjithë ditën dhe shkruani në portale çka të doni. Unë kam respekt të njejtë ose më shumë se ju. Kur them më shumë se ju, e nënvizoj se nëse më vjen mua një pale në zyre dhe kur e thotë çka është kjo fotografi ose ajo aty, d.m.th unë nuk e kam heq fotografinë e Rugovës dhe të Ukë Bytyçit me vendos të Hashim Thaqit ose të Kadri Veselit. E kam vendos deklaraten e pavarësisë që mbulon të gjitha dhe jam bazu në ligjet e RKS-së. Kur është bë Republika e Kosovës, kur janë kry amandamentet kushtetuese dhe ligji për simbole kombëtare dhe rregullorja për zyrën i ka parapa të gjitha këto dhe i ka hudhë posht me automatizëm këto rregulloret që kanë vulën e UNMIK-ut me të cilën thirreni ju. Nëse thirreni për poena politikë, herët është për fushatë. Si drejtor i Shërbimeve Publike jam i interesuar mos me bë fare politikë. Liridoni, kolegu prej Asamnlësë ma ka dërgu një kërkesë për një sqarim për një pyetje dhe jam i hapur për të gjithë. Në fund kur ia kam kthyer emailin i kam thënë që jam i hapur për gjithëçka, për secilin projekt, për çdo gjë që ka të bëjë me çështje të përgjithshme për të cilat rregullohet mirëqenia qytetare. Kjo çështje nuk e rregullon mirëqenien qytetare, kjo është çështje për konsum politik me të cilën unë nuk kisha prefer m'u marrë fare. Unë kam respekt të njejtë si ju për familjen e Ukë Bytyçi, për të gjitha familjet kontributdhënëse për shtetformimin e RKS-së mirëpo këtë çështje ju garantoj dhe ju them me plot përgjegjësi që nuk e kam bë për çështjet politike fare. Unë këto i kam eliminu krejt, e kam vendos deklaraten e pavarësisë dhe edhe ashtu ajo zyre do të shkojë në procedure të renovimit sepse është shumë e vjetër dhe nëse keni dikush bjereni dhuratë fotografinë e Ukë Bytyçit dhe unë e vendosi sepse ajo ka qenë shumë e vjetër.

Kryesuesi - drejtori u zotua që në moment që ta rregullon zyrën.

Amir Hoxha - nëse e doni për përdorim të sinqertë po, për çështje politike jo.

Mimoza Bjaraktari - për çështje politike jo por unë deklaroj publikisht që unë ka me ta sjell dhuratë fotografinë e Ukë Bytyçit.

Avni Bytyqi - ligji për vetqeverisje lokale është një mini-kushtetutë për komunat e RKS-së. Neni 7 Simbolet decidivisht e thotë: komunat kanë të drejtë të përdorin simbolet e veta. Paragrafi 2 thotë:

Komuna i miraton simbolet e veta për ti vendosur në institucionet e veta. A është vendim i UNMIK-ut me vulë të UNMIK-ut apo me vulë të Republikës së Shqipërisë, apo të Kosovës, pak qon peshë ajo punë për arsye se është ende në fuqi dhe ky kuvend ende nuk e ka shfuqizuar atë vendim dhe vendimi është në fuqi.

Nexhat Ramadani - unë e mora sinqerisht këshillën tënde mirëpo kjo që thotë drejtori mor kahje tjetër dhe nuk do të duhej drejtori me thënë kështu. Ne po mbrojmë një vendim të kuvendit të komunës që nuk është shfuqizuar dhe këto vendime vetëm ky kuvend i shfuqizon. Nuk ka të bëjë me politikë, ne po kërkojmë që me u zbatu një vendim dhe vendimin ne e denojmë sepse është akt i ulët. Më e ndershme është me thënë që nuk kam pas informacione ose kam gabu se me fol kështu. Kërkojmë nga institucioni i Kryetarit të marrë hapat e domosdoshme që të zbatohet vendimi që është ende në fuqi.

Urim Suka - ne ishim shumë të kujdesshëm dhe as nuk përmendëm drejtor por vetëm e përmendëm si ngjarje çka ka ndodh. Po mos të ishte vendimi, ne s'do të kishte logjikë as me përmend por është vendimi që është në fuqi. Për punën që e ka nis drejtori unë i kam disa vlerësime pozitive por për këtë pjesë, këtu është gabim sepse këtu nuk po rrespektohet një vendim. Lusim Kryetarin dhe secilin që është përgjegjës, jo vetëm për figurën e Ukë Bytyçit por për secilën që është e rregulluar me ligj që zyret tona me i pas fotografitë e personave që është e rregulluar me ligj, le të vendosen dhe le të funksionin

komuna qysh na ka hije.Nëse mendoni që vendimi është i padrejtë,shfuqizone.Të jemi pak më të kujdesshëm në trajtimin e temave dhe mos ti japim shumë emocion sidomos kësaj teme.

Labinot Halitjaha - është një temë që ndoshta nuk është mirë me bo temë shumë të madhe sepse është edhe një vendim.Nëse në zyrat e gjithë drejtorave tjerë është fotografia e Ukës atëherë është me të drejtë me thënë që drejtori e ka bërë diçka qëllimshëm por për deri sa në zyret tjera nuk ekziston,pse? Këtu shihet që keni qëllimisht politikë.Më vjen keq,kjo nuk ka kuptim.

Nexhat Ramadani - ne nuk kemi pas informacion që nëse ka ndodh,tash po del një marrë edhe më e madhe.Ne në momentin që kemi marrë informacion për këtë,e kemi ngrit si çështje.

Pika 11.Pyetje dhe përgjigje;

Vlorë Kryeziu - në një nga mbledhjet e mandatit të kaluar të kuvendit komunal,propozimi për heqjen e taksës në aktivitet të bizneseve lokale,dua të di nëse kjo taksë është hequr apo vazhdon të jetë ende në fuqi.Nëse nuk është hequr,propozoj të shqyrtohet përsëri dhe të vendoset si pikë e rendit të ditës në një nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit.Mendoj që heqja e kësaj takse do të ishte një lehtësim për bizneset lokale të cilat po përballen në shumë sfida dhe vështësi në aktivitetin e tyre të përditshëm.

Kryesuesi - nuk është heq taksë në aktivitet dhe është ende në fuqi.

Dardan Berisha - në seancën e kaluar e kam bërë një pyetje rreth DKA-së në lidhje me orarin mësimor të disa klasave në shkollën fillore "7 Marsi".Nënkryetarja është përgjigj por me sa kam informacione për veq ankesave të cilat i kanë prindërit në lidhje me orarin mësimor,unë e di që shkolla punon me dy ndërrime por qysh e kam thënë atëherë dhe prap e them se më e rëndësishme është fillimi i orës se sa mbarimi.Ka fillu me u zbatu 3 ditë por pas 3-4 ditëve ka fillu me vazhdu e njejtja ecuri.

Remzi Bajselmani - e kam marrë pyetjen,kam bisedu me drejtorin dhe i kam rekomandu që ti ftoj tri mësueset me diskutu me prindërit.Ka fillu me zbatu por pas një jave më ka telefonuar dhe ka thënë që nuk po mund ta zbatoj për shkak të numrit të madh të nënave të cilat kanë kërku që ky vit të përfundoj si është orari dhe ju garantoj që viti i ri mësimor do të jetë me fillim pa ndryshime prej orës 08:00 dhe prej orës 13:00 për ndërrimin e mbasditës.

Dardan Berisha - duhet me pas parasysh që këtu po ngre një shqetësim të disa prindërve të cilët punojnë nëpër institucione,të cilët po duhet me i prit fëmijët deri në ora 08:40 deri sa të kryhet ora e parë mësimore.

Jehona Rrafshi Lumi - sot gjatë homazheve në nderim të martirëve të familjes Berisha në Suharekë u përballa me një sfidë shumë serioze.Tek lapidarët ku janë vorrezat nuk janë të shënuar emrat e viktimave.U vërejt se një pjesë e emrave janë fshirë dhe mezi lexohen.Kjo është e papranueshme dhe cenon dinjitetin e kujtimit për ata që sakrifikuan për jetë.Si përfaqësuese e kuvendit komunal të komunës kërkoj nga institucionet përgjegjëse që urgjentisht të ndërmarrin masa për të respektuar këta emra të cilët me dinjitet do ti ruajmë në kujtesën tonë.Kërkoj sqarim se cila drejtori është përgjegjëse, sigurisht kultura është përgjegjëse për mirëmbajtjen e lapidarëve dhe pse nuk është intervenuar me kohë.

Kryesuesi - Drejtoresha e Kulturës e merr parasysh këtë shqetësim dhe në të ardhmen e riparojmë.

Liridon Fandaj - Është shumë shqetësuese që komuna jonë sot nuk ka asnjë farmaci që punon 24 orë.Kërkoj që Drejtoria e Shëndetësisë së bashku me Kryetarin ta hartoj dhe ta zbatoj menjëherë një plan për kujdestari të farmacisë 24 orë duke e bërë me rrotacion për secilën që mos me pas keqkuptime që me favorizu dikënd. Qendra për autizëm nga kush menaxhohet,nga kush financohet dhe cila është mundësia që ne si kuvend komunal me marrë një vendim që ata fëmijë të lirohen nga pagesa? Unë e kam marrë si informacion që ata paguajnë 100 euro në muaj.Është e rëndë sepse atyre veq u pamundësohet puna dhe obligohen m'i pagu edhe 100 euro shtesë për shërbime në qendrën e autizmit. Kur do ti zgjedh drejtorët që i ke ushtrues detyre Drejtoria e Arsimit dhe a pritët m'u hap konkurs apo je në procedure për konkurim? Unë pa përfundu ky mandat,drejtorit të Financave,tash koleg asambleist i kam kërku një listë të obligimeve të bizneseve që i shfrytëzojnë pronat publike e që është një vlerë shqetësuese,afërsisht 760,000.00€ por 4 vite drejtori nuk e di që ka marrë ndonjë masë për veq njoftimeve që i ka dërgu për me dërgu në përmbarues dikënd.Të paktën pronat publike që e kanë shkel kontratën,ato duhet me u shkëput prej Kryetarit.Është shqetësuese që pronari që e menaxhon tregun e qytetit i ka 65,000.00€ borgj e prapë tregu nalt pa kurrëfarë kontrate,shkojnë ata bujqit me nga 5 fije porri dhe ia merr nga 5€-7€ e nuk ka as kontratë.Mos të mirremi sepse ne jemi kolegë këtu e jemi qytetarë të kësaj komune që çdo lëndë me qu në prokurori ose për mosveprimet e juaja.Andaj tu lus si

dejtoresh që të merr masa dhe këto biznese bashkë me zyrën e Kryetarit t'ia shkëputni kontratën dhe ti qoni në përmbarues sepse ato janë të hyra për komunën dhe janë taksa të qytetarëve.

Herën e kaluar i kam bërë pyetje Drejtorit të Inspeksionit për objektin e Elkosit se a ka leje por nuk më ke dhënë përgjigje. Iu kam drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit dhe Drejtorinë e Urbanizmit ma ka ofruar një pëlqim ku në atë pëlqim thotë që ai ka kërkuar renovim të objektit por realisht ai ka ndërtim të objektit.

Ju si Drejtori e Inspeksionit a e keni mbikëqyr këtë objekt? A i ka tejkaluar paramasat që i ka pas herën e kaluar qysh e ka pas objektin? Edhe pëlqimin edhe lejen duhet me pas të vendosne ai që me ditë kush është duke ndërtuar dhe çka është duke bërë. Te Drejtorinë e Bujqësisë e kam një shqetësim ku edhe mandatin e kaluar ia kam bërë pyetjen drejtorit. Ferma "EkoFermë" në Dubravë, ai si fermer është i dëmtuar tash e sa kohë për 10 kamiona zhavor. Nëse ka mundësi në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë ose Drejtorisë së Shërbimeve Publike me rregullu.

Armend Krasniqi - fermën në fjalë e kam vizituar dhe është ashtu siq keni thënë ju. Ne në dispozicion i kemi 100,000.00€ për hapjen e rrugëve fushore dhe në momentin e inicimit të procedurave dhe shpalljes së fituesit të tenderit, 10 kamiona zallë kemi me ia dërgu dhe kemi me ia rregullu atij.

Nënkryetarja - sa i përket pyetjes për shëndetësinë do t'ia përcjell drejtoreshës por si qytetare më ka ndodh me ble barna natën dhe ka pas barnatore që ka punu në Suharekë. Me çfarë vendimi nuk jam e informuar por ka pas barnatore që ka punu. Sa i përket qendrës "Duje" edhe para se me qenë nënkryetare e komunës, e kam taku zonjën që udhëheq në këtë qendër dhe nuk kanë qenë në objektin ku janë por kanë qenë në klasat e shkollës "7 Marsi". Fatkeqësisht ata ende nuk janë të regjistruar si shoqatë. Komuna në bazë të donacionit që ka marrë të objektit nga bizneset, ia ka mundësu objektin fizik me qëndru. Ajo vazhdimisht thotë: unë i kam gati dokumentat dhe vetëm licencimi më duhet. Kam katër vite që e dëgjoj këtë gjë dhe nuk e di çfarë problemi ka. Në momentin që nuk janë të licencuar si shoqatë, ata nuk mundin me apliku as për fonde, as në projekte dhe as kurgja. Ju si kuvend i keni nda fonde Hendikosit por nuk mundeni m' i nda asaj që s' është as shoqatë se s' ki si e bën procesin. Është e vërtetë që nënat paguajnë. Mendoj që është mirë me diskutu me atë zonjën dhe me kërkuar nëse ka staf për licencim ose me e ndihmuar çka mundemi ose me ia mundësu dikujt tjetër që ka staf.

Liridon Fandaj - Nëse kjo qendër është duke funksionu jashtë rregullave, është shqetësuese edhe për qytetarët. Te rregullorja e farmacive, më ka ndodh edhe mua me ble por rregullore nuk ka. Drenasi dhe Shtimja kanë plan të kujdestarisë dhe punës së barnatoreve dhe e bëjnë me rrotacion.

Avni Bytyqi - ekziston rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për të gjitha aktivitetet biznesore dhe në kuadër të asaj rregullore nëse nuk gaboj është e paraparë që njëra prej barnatoreve duhet të kujdestarohet 24 orë mirëpo Drejtorinë e Shëndetësisë a ka ndonjë plan operative që në mënyrë rrotative secila barnatore të përfshihen, këtë nuk e di por besoj që bëhet. E di që ka qenë një kërkesë mandatin e kaluar nga PDK për me fillu një procedure për plotësim-ndryshimin e asaj rregullore por nuk ka vazhdu më tutje. Besoj gjatë këtij mandati kemi me fillu me bërë plotësim-ndryshimin e rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës dhe në një formë kemi me obligu që një barnatore së paku me kujdestaru në qytetet.

Liridon Fandaj - edhe nëse bëhet ajo rregullore është mirë me bërë një plan dhe me qenë obligative që me rrotacion secili me pas punën 24 orë.

Labinot Halitjaha - sa i përket orarit të barnatoreve, i kam thirrë në takim komplet farmacistat e barnatoreve në Suharekë. Kemi pas një takim 1 orë e gjys por shumë kanë pas kundërtënie në mes vete dhe në fund kam dal nga takimi dhe nuk jam marrë më. Është mirë që Drejtorinë e Financave së bashku me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe me Kryetarin me mbajtë një takim dhe me bërë me rrotacion të obligueshëm që së paku një barnatore me qenë hapur 24 orë.

Remzi Bajselmani - sa i përket drejtorave është e vërtetë që në 2 shkolla kemi pas vonesa dhe kemi mbet me ushtruesat detyre. Tani janë hapur 6 pozita për drejtor, konkursi është public dhe në Asamblenë e radhës do të vje një komision i cili do të aprovohet në Kuvend dhe do të bëhet përzgjedhja e drejtorëve.

Liridon Fandaj - nuk mundet me lënë dikënd ushtrues detyre nëse nuk i plotëson kushtet. Këtu je duke e bërë një shkëlqje që 4 vite dhe e ke një rekomandim prej ministrisë. Me atë rekomandim ti mund ta bësh një ushtrues detyre tjetër por jo dikënd joprofesional me lënë ushtrues detyre të drejtorit.

Remzi Bajselmani - nuk kam rekomandim.

Gent Gashi - Elkosi ka leje nga 2016-ta. Për momentin është në rikonstruim dhe ka një leje për renovim për shkak të fatkeqësisë që i ka ndodh. Nuk e ka tejkaluar asnjë paramasë, është objekti i njejtë, është materiali i njejtë që është duke u ndërtuar në të njejtin vend.

Liridon Fandaj - nuk kam asgjë kundër biznesit por ne shohim dhe kuptojmë. Unë të thash vetëm zyrtarisht dhe nëse ka mundësi me i sjell procesverbalet që i ke mbikqyr. Nëse u dëmtu objekti është renovim tjetër por jo ndërtim i ri. Leja 2016 e sot jemi në 2026-tën.

Gent Gashi - në momentin që ka fatkeqësi ligji e thotë që i lejohet leja ndërtimore.

Liridon Fandaj - gjeje ligjin dhe rregulloren ku po thirrresh. A ki procesverbal? A ka tejkalime?

Gent Gashi - po ka procesverbal dhe çdo betonim është me procesverbal.

Erëza Ramadani - Të gjithë obliguesit kanë marrë vërejtje me vite në vazhdimësi. Jemi duke diskutu për procedurat që në vazhdimësi me u nxerr ato obligime me procedura ligjore.

Urim Suka - unë i kam bërë disa pyetje seancën e kaluar për Drejtorin e Arsimit dhe unë deri në këto momente nuk kam marrë përgjigje. Këto ditë unë e kam vizitu QMF-në në Duhël dhe në fakt në shtator bëhen 2 vite që QMF-ja është përrurë dhe që nga ajo kohë ata nuk kanë ujë. Ata aktualisht furnizohen nga restaurant Gizi por ajo është komplet mbi tokë dhe gjat dimrit po ngrihet dhe shpesh here kanë mungesë të ujit. Është e çuditshme se si për 2 vite nuk keni qenë në gjendje një pus të vogël me bërë ku pak mjete do ajo. Dua të di a do të ketë zgjidhje problem i ujit? Aty unë pashë edhe dy problem tjera, ku një problem ishte mungesa e perdeve në katin e dytë dhe sidomos verës krijon problem të madh. Edhe problem i rrugës, ku nga rruga kryesore deri te ambulanta për me hy qytetarët, është baltë. Afërsisht janë 40 m dhe shumë pak mjete don për me bërë atë zgjidhje dhe është e çuditshme. Para katër vite pata kërku me formu një komision në Asamble për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe nuk e di pse detyrohem prap me bërë kërkesën e njejtë. Janë detyra që duhet me i ditë vet si pushtet. Kur ndërrohet pushteti, kryesuesi apo si Kuvend e kemi për obligim me formu menjëherë një komision i cili del në teren dhe duhet m'u zgjedh këshillat e fshatrave në secilin fshat. Ju rekomandoj që seancën e ardhshme me ardhë kjo pikë për formimin e këtij komisioni dhe i rekomandoj të gjitha partitë që secili fshat ta ketë një këshill prej të gjitha partive mbi bazën e rregullores.

Avni Bytyqi - udhëzimi administrativ i MAPL-së dhe rregullorja për funksionalizimin dhe organizimin e kryesive të fshatrave e thotë decidivisht: mandati i kryetarëve të fshatrave është në mimentin kur zgjidhet dhe nuk lidhet me mandatin e anëtarëve të kuvendit e as të kryetarit të komunës. Kur t'ju del mandati besoj dhe shpresoj që ne kemi me inicju këtë procedurë.

Remzi Bajselmani - mbledhjen e kaluar keni bërë pyetje për procedurat për përzgjedhjen e këshillit të prindërve në komunën e Suharekës për të cilën unë nuk e di ku është kontesti dhe për dy shkollat që janë në ndërtim nga Ministria e Arsimit. Për shkollën në Vraniq kemi pas shqetësime vazhdimisht. Mbi 20 herë kam shku fizikisht i kemi taku. Shkolla ka pas shumë probleme për me vazhdu por fatmirësisht sot janë duke u bërë punime shumë intezive dhe zotimet nga punëkryesi janë që deri në qershor përfundon shkolla në Vraniq. Ndërsa shkolla në Samadraxhë është brenda kornizave të afatit ligjor për ndërtim dhe është duke u punu dhe kjo pritet në shtator me u funksionalizu.

Urim Suka - këshillat e fshatrave në bazë të rregulloreve, për veç Kryetarit aty zgjidhet komplet këshilli dhe këshilli në bazë të rregullores del prej zgjedhjeve, varësisht sa ka fitu partia aq anëtar ka në këshill. Nuk ka kuptim me lidh mandatin e kryetarit të fshatit dhe të këshillit të fshatit jashta zgjedhjeve.

Avni Bytyqi - unë e sqarova se si është me rregullore dhe me udhëzim.

Urim Suka - me që pyetjen e parë nuk e pat të qartë Drejtori i Arsimit, pyetja ka qenë: këshilli i prindërve që ju e keni themelua, a është zgjedh sipas procedurave ligjore?

Remzi Bajselmani - procedurat për përzgjedhjen e këshillit të prindërve në kuadër të komunës janë kryer sipas udhëzimit administrative 01/2023 pa u tejkalu asnjë procedurë. Procedurat i kanë kryer zyrtarët e DKA-së bashkë me përfaqësuesit e këshillit të prindërve. Ka pas kuorum, kanë qenë mbi 21 persona. Për këtë ta kam përcjell udhëzimin dhe vendimin që është themelua këshilli i prindërve.

Urim Suka - udhëzimi thotë që anëtarët e këshillit të prindërve në nivel komunal nuk kanë të drejtë me qenë mësimdhënës. Aty e ke plot mësimdhënës këshillin e prindërve.

Remzi Bajselmani - ata janë vetëm anëtar dhe nuk kanë rol.

Urim Suka - këtu dy mësimdhënës po i shoh menjëherë. Nuk është respektu udhëzimi. Aty thotë që anëtarët e këshillit të prindërve nuk mundën me qenë kandidatë për asamble që kanë qenë në garë politike brenda 3 viteve të fundit. Ke edhe kandidat që kanë qenë dhe është në këshillin e prindërve.

Ky këshill i prindërve nuk është ligjor dhe sapo e konfirmoi edhe vet drejtori që nuk është ligjor se këtu ka anëtar që janë në kundërshtim me udhëzimin administrative.

Remzi Bajselmani - unë nuk e konstatova. Procedurat janë zhvillu sipas udhëzimit dhe bartëse kanë qenë zyrtarët e DKA-së që nuk kanë pas asnjë tendencë për asnjë person.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor nxjerr udhëzimin e këshillave të fshatrave dhe e lexon.

Flamur Bytyçi - kam shqetësime prej bizneseve dhe prej njerëzve që kanë pas interes për bonus ndërtimin. Ku ka mbet procedura? Çka ke bo? Pse nuk po e bjen për me rrit, qysh e ke sjell herën e kaluar me ngulm dhe na keni bërë presion neve, edhe njerëzve? A i ke përmbush kriteret, ato përgjigje që ti ka kthyer ministria. Deri ku ka m'ri kjo çështje? Te çështja e zonës unë e kam kërku një raport dhe e falemderoj Armendin që ma ka dërgu, që nuk ka qenë e përfshirë herën e kaluar. Në bazë të kësaj i keni kthyer përgjigje Kryetarit me anë të cilës ju i referoni edhe qarkores. Përmendët më herët që keni largu njerëz prej banesave. Në cilin ligj, në cilën qarkore jeni lidhur që ju keni largu njerëz prej banesave meqenëse keni pas ndoshta të drejtë për shkak të obligime që ata i kanë pas komunës por në anën tjetër nuk keni pas guxim me marrë masa ndaj bizneseve për të cilat ata nuk e kanë bërë asnjë investim dhe kanë edhe obligime. A e ke përdorur të njëjtën qarkore kur ke marrë vendim për m'ri largu prej banesave? A e ke marrë vendimin vet apo i keni rekomandu Kryetarit dhe Kryetari i ka largu prej banesave? A është formu komisioni për mbikqyrje të zonës? Unë kam kërku raporte të shpenzimeve herën e kaluar dhe nuk është përfshi në procesverbal. I kam kërku drejtoreshës raportet për shpenzimet e zyrës së Kryetarit dhe shpenzimet e ushqimit dhe pijeve, nuk e kam pranë një raport. Sa ka obligime komuna e Suharekës ndaj operatorëve të cilët i kanë kry punimet?

Visar Kuçi - sa i përket rregullores së bonuseve ne jemi në kontakt me ministrinë përkatëse. Është duke punu me listat e planifikimit prej Gizit që i mban. Kemi me i marrë masat dhe kemi me vazhdu me rregulloren e bonuseve dhe rregulloreve tjera.

Flamur Bytyçi - nuk është përgjigja që ajo unë e kërkoj meqenëse herën e kaluar kur ka ardhë vendimi ka ardhë me trysni të madhe, me shumë kërkesa e përpjekje për me votu dhe një pjesë e kualicionit që ju jeni në qeverisje nuk e kanë votu. Çka do ti thoni sot atyre bizneseve për të cilat edhe neve na kanë bërë presion?

Sanie Kuçi Rexhepaj - sa i përket pyetjes së Flamurit drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit, kur ministria ka kërku shfuqizimin e rregullores, ka kërku që Drejtoria e Urbanizmit komuna e Suharekës me raportu në kuvend mbi zbatimin e PZHK-së dhe HZK-së. Pyetja e Flamurit qysh unë e kuptova është se a keni ndërmarrë masa për me i plotësu ato kërkesa të ministrisë që mandej me pas mundësi me sjell rregulloren për miratim në kuvend.

Visar Kuçi - unë u përgjigja. U shfuqizu vendimi i cili ka qenë mandatin e kaluar, kemi qenë në zgjedhje. E kam marrë mandatin dhe jemi duke punu.

Flamur Bytyçi - ta ka kthyer negative dhe ti ka kthyer dy kritere për të cilat nuk kalon dhe ti nuk je përgjigj dhe neve nuk na ke sjell një raport.

Kryesuesi - kuvendit ja ka kthyer dhe vendimi kur ka ardhë te ne, e kemi shfuqizu. Drejtori tha që po punon në atë drejtim.

Armend Krasniqi - dallimi mes atyre të larguarve nga banesat dhe kontratat e cilat i kemi pas në zonën industriale. Dallimi i atyre është që ata nuk kanë pas kontrata dhe kanë vazhdu me jetu në banesat të cilat i kanë zënë dhe nuk janë tatim nga komuna për me pagu qeranë. Në zonën industriale ka pas probleme të vazhdueshme dhe e dimë si kanë rrjedh ato probleme. Nuk janë liru vetëm banesat gjatë mandatit tim, janë largu nga pronat e uzurpuara mbi 100 uzurpator. Po ashtu gjatë 4 viteve nuk kanë ndodh asnjë uzurpim i pronave komunale sepse jam kujdes shumë. Te banesat dhe lokalet nuk ka pas gjendje aq të rëndë. Nuk ka pas as banesë, as local, as tokë ka i bje që u ditë cila është e komunës, çka është e komunës. Me verifikimin, regjistrimin, dhënien e numrit personal ne i kemi regjistru në kataster pronat e Suharekës dhe aty kemi konstatu dhe i kemi definu se cilat janë pronat e komunës.

Flamur Bytyçi - me që përmende që s'ka uzurpime, po e përmend një uzurpim që ka ndodh në Maqitevë, te shkolla. Aty veq shkoll nuk është, e ka ndërru destinimin, si kafiq apo nuk e di çka dhe asnjë masë nuk e keni marrë. Edhe në zonë ka pas kontrata të cilat kanë qenë të shkëputne dhe keni mujt me kry punë. Për ato që ke punu unë të kam dhënë mbështetje për çështjen e raportit mirëpo për çështje tjera që i ke pas, 4 vjet mandat dhe për 4 vite s'ke bo komision për zonë.

Armend Krasniqi - sa i përket çështjes së shkollës, në momentin kur ka intervenu një person për me rregullu hotel a kafe, nuk e di, rasti është lajmëruar në drejtpronë e inspeksionit. Drejtoria e Inspeksionit kanë shku dhe e kanë ndërpre procedurën dhe procedurën janë duke e vëzhguar. Nuk ka asnjë rast gjatë 4 viteve.

Liridon Fandaj - drejtor tregu i qytetit a është i uzurpuar? ai nuk ka kontratë.

Armend Krasniqi - tregu është zhvendos në një lokacion tjetër. Pranimi teknik akoma nuk ka ardhë dhe akoma nuk kanë filluar procedurat për dhënien e asaj prone në shfrytëzim. Unë kam rekomandu dhe e

kemi vendos në listën e pronave për dhënie në shfrytëzim dhe besoj shumë shpejt do të nisim procedurat.Nuk kam informacione që aty ka hy dikush në atë treg.

Mensur Selimaj - jo s'kam formu komision.Po pres që ministria me kthy vendimin pastaj me fillu me procedurat tjera.

Flamur Bytyçi -nuk ke nevojë me prit ministrinë sepse ti e ke obligim ligjor me formu komisionin.

Erëza Ramadani-seancën e kaluar ke kërku raport të shpenzimeve për zyrën e Kryetarit.Do ta përgatis një raport dhe do ta dërgoj në email bashkë edhe me borgjet të cilat i kërkoje.

Nënkryetarja - të gjitha vendimet që Kryetari i ka pas mbi mbushjet dhe pijet,i ka shfuqizu dhe për momentin janë bë vendime të reja në të cilat kanë një sasi të vogël të mbushjeve drejtorat,shefi i kabinetit,Kryetari dhe nënkryetarja.Është një rreth qe disa vite në të cilët zyrtarët komunal marrin nga 2 euro mbushje dhe flasim me kolegët brenda rrjetit.Unë personalisht jam marrë me këtë çështje dhe e kam verifiku secilën drejtori dhe secilin numër a është staf,a ka dal në pension dhe a vazhdon me punu.Të gjitha listat janë korigju dhe gjithëashtu është një listë e infermiereve që punojnë në teren të cilëve Kryetari ia ka mundësu nga 5 euro mbushje.

Flamur Bytyçi - kjo që po e thua tash,a ka hy si shpenzim i zyrësë Kryetarit apo shpenzimet janë bë në Drejtori të Shëndetësisë?

Nënkryetarja-deri tash që i kam pa kontratat këto 2 euro iu kanë faturu drejtorive të veçanta përveç prokurimit dhe krejt çka jemi me zyre të Kryetarit,kanë shku te zyra e Kryetarit dhe mbushjet e drejtorave janë faturu komplet te zyra e Kryetarit andaj ka qenë shuma e madhe.

Astrit Salihu - është një kërkesë që më është adresuar nga qytetarët.Te pjesa e sheshit nga ura deri te zjarrëfikësat janë vendosur disa pengesa të betonit dhe hapësira e rrugës kryesore ka mbet shumë e ngushtë.Pasi nuk ka përfunduar akoma sheshi dhe nuk është bë ende pranimi teknik,ndoshta ka mundësi të rishikohet kjo pjesë që këto pengesa të futen më brenda sheshit pasi në ndonjë rast nevojë për intervenim të veturës së policisë apo ambulantës,nëse komunikacioni është i rënduar atëherë mundësia për të liruar rrugën për një intervenim të shpejtë është e pamundur.

Visar Kuçi - sheshi nuk ka përfundu dhe jemi duke e shqyrtu mundësinë me bë një zgjidhje.Ka pas kërkesë edhe prej policisë.

Merita Basha - tani jemi ka fundi i viti shkollor,sidomos për maturanët.E dime që në fund maturanët ballafaqohen me testin e matures dhe e dime që ata duhet m'u përgadit ne forma të ndryshme.Si drejtori e Arsimit a keni planifiku diçka konkrete sepse me informacionin që e kam mbahen mësim plotësuese por në mënyrë vullnetare prej mësimdhënësave?

Remzi Bajselmani - data e testit të maturës është përcaktu dhe përgaditjet Ministria e Arsimit i ka fillu. Sa i përket përgaditjes së maturanëve tri shkollat e mesme të larta e kanë një planprogram me të cilën punojmë dhe i testojmë nxënësit dhe i udhëzojmë se si rrjedhin procedurat.

Merita Basha - në lagjen te banesat e Ballkanit dhe te Rozafa e vjetër,banorët që janë të rregullt atje kanë problem me parkingun.A ka ndonjë zgjidhje që ata me u identifiku me ndonjë etiketë që janë banorë të rregullt?Gjinnazi e ka dhe shkolla në Shirokë e ka dhe funksionojnë shumë mirë.

Visar Kuçi - ne e kemi miratu një rregullore në Asamble që i përfshin edhe parkingjet.Banorët rezidentë mund të marrin një leje përkatëse me orar të caktuar por nuk aplikojnë asnjë.

Merita Basha - si identifikohen ata?

Visar Kuçi - ai paiset me leje,pëlqim që është banor rezident i asaj lagje dhe e ka kohën e caktuar.

Enver Shabani - mua si qytetar më interson të di,nëse unë jam banor resident te banesat e ballkanit dhe dua të kem parking të përhershëm.

Visar Kuçi - e ke një rregullore dhe ti mundesh me rezervu një parking dhe me pagu,p.sh. prej ores 18:00 deri në 08:00.Gjatë ditës nuk mund ta bllokosh një parking të qytetarëve.Nëse nuk gaboj sepse ti ndoshta mund ta paguash edhe 24 orë por kostoja është shumë e madhe.

Merita Basha - ka raste që e parkojnë makinën aty dhe shkojnë në Prizren ose në Prishtinë punojnë.

Visar Kuçi - në lagjen tuaj ka makinë që është e parkuar edhe 90 ditë. Me ligj në të 21 ditë nëse një makinë s'ka lëvizë prej një parkingut publik,ditën e 22 ke të drejtë me thirr policinë e Kosovës ku vin dhe e marrin.

Merita Basha - a mundet me ekzistu ajo formë që me etiketa m'u identifiku banor i rregullt i lagjes?

Avni Bytyçi - drejtor trego se si është menaxhimi i parkingjeve në Prishtinë.Jepet në shfrytëzim i gjithë parkingun,ndahen për banorët dhe pjesa tjetër paguajnë.Komuna jonë nuk e aplikon këtë çështje dhe nuk ka interes m'i denu qytetarët.

Takimi përfundoi:15:41

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj